

REVISTA STUDENTORE

UNT studenti

ZËDHËNËSE PËR TË ARRITUR NË BOTËN E SHKENCËS DHE DIJES

UNT-JA E PËRCAKTUAR PËR STUDIME CILËSORE
DHE REZULTATE TË LARTA | fq.4

INFORMATIKA NJË FUSHË DINAMIKE
QË NDRYSHON ME HAPA TË
SHPEJTA | fq.10

BOTIMET AKADEMIKE DHE FONDI I LIBRAVE
SI PJESE E DIJES PËR STUDENTËT | fq.29

UNË E "DUA" AUTO-CENZURËN | fq.31

POETËT E RINJ, MOTIVIM PËR RININË | fq.42

Gjenerata e parë e apsolventëve të UNT-së hodhi kapelat



Revista “UNTstudenti” – zëdhënëse për të arritur në botën e shkencës dhe dijes!

*Koordinator i revistës
Prof.dr. Mustafa Ibrahim*

Duke ditur se studentët janë shpresa e një kombi dhe shtetit, sidomos zhvillimit të shkencës, ata kishin nevojë për një tribunë, ku do t'i shprehnin aftësitë e tyre komunikuese dhe shkencore. Përveç kësaj, nëpërmjet revistës duhet të përgatisim kuadro të reja dhe studentë me imazh.

Revista UNTstudenti, fillon rrugëtimin e informimit, atë e bartin studentët e të gjitha fakulteteve të UNT-së, sidomos ata të mediave që do ta mbajnë peshën më të madhe. Me shkrimet e tyre, ata po hapin një horizont të ri ku do kenë mundësi të komunikojnë hapur mes tyre dhe të zbulojnë cilat janë pikat rreth të cilave ata do të mund të bashkëpunojnë me “të tjerët”, njëkohësisht ata do të shprehin pikëpamjet e tyre për shumë aspekte, dukuri e gjëra tjera të rëndësishme për ta.

Vetë titulli i revistës “UNTstudenti”, siç thamë është zë i gjithë studentëve që e duan dhe studiojnë në UNT, ku do t'i shprehin kërkesat reale, por edhe do të garojnë mes veti dhe mes tjerave, me sukseset e tyre për të arritur në botën e shkencës dhe dijes. Revista do t'i ketë dyert e hapura jo vetëm për studentët e këtij universiteti, por edhe për të gjithë studentët nga rajoni dhe me gjerë, të cilët do vënë para vetes qëllime të ndryshme, siç janë njohja me problemet, kulturën, programet, aktivitetet dhe perspektivën e studimeve në këtë universitet. Me shkrimet e tyre, studentët do të hapin mundësi për shkëmbime idesh, përvojash dhe programe të reja. Kjo revistë përveç informative, do të jetë edhe tribune për të zbuluar talentë të dalluar, studiues të rinj në fushat e ndryshme dhe do të rris bashkëpunimin, sepse shkenca ashtu zhvillohet.

Vlen të përmendet kontributi i pashoq dhe vullnetar i studentëve, pa të cilët nuk do të botohej numri i parë i revistës, sidomos: Emel Aliu si kryeredaktore dhe Sevdije Ramadani si redaktore përgjegjëse e revistës. Falënderojmë edhe anëtarët e tjerë të Këshillit redaktues, në përbërje: Sejdina Azizi, Fatih Qaili, Sumeja Lumani, Sabir Xhemaili, Rasim Ajredini dhe Fazile Halili. Falënderojmë edhe kontributin e profesorëve Agron Kurtishi dhe Avni Avdiu, të cilët i nxitën dhe motivuan studentët që të merren me shkrime. Gjithsesi merrita kryesore i takon rektorit prof.dr. Azis Pollozhanit, për iniciimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që të del një revistë të tillë studentore në kuadër të UNT-së.

Shpresojmë që revista të ketë jetë të gjatë dhe të shtohen sa më shumë numra. Studentëve ju prift e mbara dhe u urojmë fat dhe sukses në këtë nismë fisnike!

UNT-ja e përcaktuar për studime cilësore dhe rezultate të larta!



“Edhe përkundër dobësive që janë evidentuar në sistemin arsimor, kjo nuk do të thotë që ne na mungojnë entuziazmi, dëshira për dije dhe të reja dhe të rinjtë tonë që me zell janë rrekur për të përmbushur obligimet e parapara në studime dhe nga ajo që po konstatojmë, gjatë procedurave të vlerësimit po duket që në pjesën më të madhe ato ia dalin me sukses. Ky fakt ne na gëzon shumë dhe na forcon bindjen që jemi në rrugë të mirë. Sigurisht që ne synojmë suksese edhe më të larta për çka duhet punë më e përkushtuar e studentëve dhe pedagogëve për çdo ditë.”

UNT Studenti: Si e shihni cilësinë e arsimit të lartë sot dhe rrangu i Universitetit “Nënë Tereza”, në krahasim me universitetet tjera?

Rektor A.Pollozhani: Shumë kohë kaloi, prej kur arsimit nuk po duket të jetë prioritet në politikat publike, së këndejmi cilësia e arsimit të lartë lë shumë për të dëshiruar si në përgjithësi po ashtu edhe në universitetin më të ri “Universitetin Nënë Tereza”.

UNT Studenti: Jeni të kënaqur me studentët e tanishëm?

Rektor A.Pollozhani: Edhe përkundër dobësive që janë evidentuar në sistemin arsimor, kjo nuk

do të thotë që ne na mungojnë entuziazmi, dëshira për dije dhe të reja dhe të rinjtë tonë që me zell janë rrekur për të përmbushur obligimet e parapara në studime dhe nga ajo që po konstatojmë, gjatë procedurave të vlerësimit po duket që në pjesën më të madhe ato ia dalin me sukses. Ky fakt ne na gëzon shumë dhe na forcon bindjen që jemi në rrugë të mirë. Sigurisht që ne synojmë suksese edhe më të larta, për çka duhet punë më e përkushtuar e studentëve dhe pedagogëve për çdo ditë.

UNT Studenti: Duke pasur poste mjaft relevante në Maqedoninë e Veriut, si ministër i arsimit... çfarë bëri që të ndërmerreni vendimin për të konkuruar në postin e Rektorit të Universitetit?

Rektor A.Pollozhani: Pozita e ministrit është pozicion politik ku njëri përveç që realizon nje program të caktuar, po ashtu është një mundësi edhe për të pasuruar njohuritë dhe plotësimin e kompetencave për të bërë edhe diçka më shumë duke e shfrytëzuar këtë përvojë. Ishte një rastësi fatlume që u krijua një rrethanë e volitshme për të realizuar një synim të kahmotshëm për të përshpejtuar avancimin dhe fuqizimin e kapaciteteve integruese të shqiptarëve për një jetë më të mire për gjeneratat e reja. Universiteti në kryeqytet është një mundësi që nuk duhet lëshuar si nga nxënësit poashtu edhe nga arsimdashësit tjerë.

UNT Studenti: Keni përkrahjen maksimale nga institucionet kyçe, për progresin e Universitetit "Nënë Tereza"?

Rektor A.Pollozhani: Duke marrë parasysh rrethanat dhe elementet dominues të këtyre rrjedhave, ku arsimit nuk ka qënë i evidentuar, mund të thuhet se edhe përkundër kësaj situatë organet qeveritare e kanë mbështetur themelimin dhe zhvillimin fillestar të Universitetit. Ne jemi në pritje të një mbështetjeje edhe më përmbajtësore dhe më efikase në përputhje me nevojat e studentëve.

UNT Studenti: Cilat janë shkaqet që e pengojnë ndërtimin e një objekti të posaçëm për Universitetin "Nënë Tereza"?

Rektor A.Pollozhani: Ndërtimi i Kompleksit Universitar „ Nënë Tereza,„ është i vetmi objekt infrastrukturor që është shënuar në programin qeveritar që duhet realizuar gjatë mandatit të saj. Sikurse po shihni qeveria po vonohet , madje jo pak, në realizimin e kësaj pike të programit të vet qeveritar. Studentë po presin kompleksion universitar të premtuar, në ndërkohë në më 8 qershor do të promovojmë të diplomuarit e parë në UNT. Të parët që po bëjnë historinë.

UNT Studenti: Ju si personi kyç i këtij Universiteti, si e shihni Universitetin e parë të shqiptarëve (UT), "konkurentë" apo "kundërshtar"?

- E shoh si „bashkudhëtar,„ me mision dhe qëllim të njëjtë.

UNT Studenti: Çfarë i nxit mediat e ndryshme, të prodhojnë lajme që dëmtojnë imazhin e UNT-së?

Rektor A.Pollozhani: Mediat janë pjesë e qenësishme e demokracisë. Ato kanë lirinë të

informojnë opinionin, por kanë edhe përgjegjësinë për t'iu përmbajtë normave dhe etikës gazetareske. Me sa duket kemi probleme si me demokracinë po ashtu edhe me gazetarinë dhe kjo më shqetëson më shumë se sa sulmet e pabazuara dhe niveli i ulët që ato përdorin.

UNT Studenti: Sa i perket lajmeve negative në media , që kanë të bëjnë me UNT-në, ju si stafë keni frikë humbjen e autoritetit në treg dhe besimin e studentëve të ardhshëm?

Rektor A.Pollozhani: Opinioni tani më ka pjekurinë e duhur për të bërë vlerësimin dhe për të bërë gjykime të drejta. Hapja e Universitetit dhe mundësimi i studimit në gjuhën amtare në kryeqytetin e vendit është diçka që nuk mund të errësohet me shpifje dhe keqinformime të qëllimshme.

UNT Studenti: Imazhi i Universitetit mund të ketë pasoja, në saj të përfshirjeve politike?

Rektor A.Pollozhani: Ligji ndalon veprimin partiak dhe fetar në institucionet e arsimit të lartë. Unë dhe kolegët e mi, si pedagogë po ashtu edhe administrata, jemi duke bërë më të mirën e mundshme për të qënë në linjë me ligjin dhe me parimet me bazë akademike dhe etike.

UNT Studenti: Në një të ardhme të afërt, jeni optimist për ta parë UNT-në, Universitet lider në Maqedoninë e Veriut, me gjithë këto përplasje mediatike?

Rektor A.Pollozhani: Gjithsesi që ne po punojmë në këtë drejtim që është misioni dhe angazhimi ynë themelor. Informimi i drejtë dhe kritik që korigjonë punën tone është për ne i mirë se ardhur , kurse shpifjet dhe qasjet joprofesionale dhe joetike nuk janë çështje që ne na preokupojnë. Ne nuk mund të lejojmë që këtë qasje qëllimkëqia të na çorientojnë dhe të harrojmë punën tonë për të cilën ekzistojmë dhe jemi ngarkuar me ligj.

Përgjegjësi dhe përkushtim për një të ardhme më të mirë

Punoj: Rasim Ajredini



UNTstudenti: Agon, a mund të prezantohesh dhe të flasësh pak për veten?

Agon : Gjithsesi. Unë quhem Agon Podragja vij nga qyteti i Shkupit. Jam student i vitit të katërt në drejtimin Informatikë-Mësimdhënie dhe njëkohësisht përfaqësuesi i Parlamentit Studentor të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup.

UNTstudenti:A mund të flasish rreth asaj se si arrite deri tek titulli që e mban sot në Universitetin tonë?

Agon : Është një storje interesante. Në fillim kur u hap konkursi që të zgjedhën pjesëmarrësit për krijimin e Parlamentit Studentor, të cilin e përbënin kryetari, nënkryetari dhe sekretari, nga ana e rektoratit u ftuan gjithë studentët që ishin kryetarë të grupave të drejtimit të tyre, që të marrin pjesë. Afati ishte dhjetëditor dhe fatkeqësisht, nuk kishte asnjë konkurent që ta gëzojë titullin si Kryetar i Parlamentit Studentor. Disa ditë para Rektori na ftoi për një mbledhje të vogël, ku na tha se duhej sa më shpejtë të zgjidhet stafi i parlamentit. Atëherë aplikua tre studentë: unë Agon Podragja, Erjon Hisa dhe Ardian Shabani. I dorëzua CV-të në të cilat ishin informatat për aktivitete dhe pjesëmarrje të ndryshme. Pasi kaloj dita e afatit, pas konsultimeve që e kishin bërë stafi administrativ i universitetit, kishin vendosur që unë ta kem përgjegjësinë si Kryetar i Parlamentit Studentor të universitetit.

UNTstudenti: Përmende se në CV-në ke shkruar për aktivitete dhe pjesëmarrje të ndryshme, me çfarë aktivitete je angazhuar më konkretisht ?

Agon : Tema e pjesëmarrjeve të ndryshme nëpër organizata jo-qeveritare dhe internele të institucionëve ka filluar që nga shkolla e mesme. Në shkollë të mesme, isha sekretar i kryetarit të organizatës "Unique Code". Po ashtu, kam qenë

udhëheqës i sektorit të Informatikës në Forumin Rinor Shqipëtar. Kam qenë pjesë edhe në konferenca të ndryshme të cilët preknin tema studentore,

UNTstudenti: Çfarë roli ka Parlamenti Studentor ?

Agon: Roli ynë është që të jemi zëri përçues nga studentat deri tek stafi administrativ. T'i zgjidhnim problemet të cilët shpijnë deri tek kërkesa të ndryshme të studentave. Ndonëse ishim për atë qëllim aty edhe pse fatkeqësisht jo të gjithë kërkesat janë plotësuar, besoj që ballafaqimet më të mëdha që kemi si studenta, në një universitet të ri, i kemi tejkaluar. Disa më lehtë, disa më vështirë, por gjithmonë kemi gjetur rrugëdalje, në një mënyre që asnjëra palë të mos ndjehet e diskriminuar. Me këtë besoj që kryetarët e ardhshëm do ta kenë më lehtë orientimin dhe përgjegjësinë e këtij statusi.

UNTstudenti: Interesante! Por për kohën që jeni kryetar, çfarë mendimi keni për pozicionin? Çfarë të mira dhe të këqija të solli ?

Agon : Për aq kohë sa jam kryetar, puna edhe pse e lodhshme, është argëtim. Pasi u zgjodha për këtë pozicion, ndonëse kufijtë e kohës mu shkurtuan, gjatë gjithë rrugëtimit kam njoftuar njerëz të ndryshëm, kam marrur pjesë në konferenca të ndryshme, përvoja të reja etj. etj. Normalisht, më janë shtuar angazhime të tjera dhe mu është dashur të sakrifikoja disa gjëra, por si konkludim, nuk e kisha menduar që ato gjëra të sakrifikuara ishin për të mirën e të gjithëve. Sa i përket të mirave dhe të këqijave, nuk mund të klasifikoj se çfarë ka qenë e mirë dhe çfarë e keqe, sepse çdo gjë më ka mësuar diçka të re dhe ende vazhdon të më mësojë. Por mbi të gjitha, statusin që e kam më bën të ndjehem mirë në njëfarë mënyre, duke qenë në dijeni që ata që kërkojnë ndihmë mund të drejtohen drejt diçkaje, apo dikujt

Por siç thash edhe më lartë edhe pse jo çdokujt mundeshim ti ofrojme ndihmë për shkaqe të ndryshme, e kemi dhënë më të mirën nga ne edhe pse nuk është realizuar.

UNTstudenti: Meqenëse edhe ti i përket këtij universiteti si student para se ti përkasësh si kryetar, cili është mendimi yt personal dhe i përgjithshëm për universitetin ?

Agon: Unë mendoj se Universiteti ka vizion shumë të qartë dhe të pastërt. Siç thonë "pas vështirësive, vjen lehtësimi" edhe "Nënë Tereza" në fillim e ka patur vështirë. Problemi që ende ballafaqohemi por po mundohemi që ta zgjidhim është ndarja e studentëve në dy objekte të ndryshme. Nuk e shohim sikur që është faji i yni apo i dikujt tjetër, mbasi mbi të gjitha jemi në një vend të dobët ekonomik, të paktën e shohim që e kemi përgjegjësi që t'i bashkojmë të gjithë në një objekt zyrtar. Stafi po punon për këtë çështje dhe do mundohen që sa më shpejtë të bëhet një union studentor, me kuptimin e plotë të fjalës. Sipas informatave të mija të statistikave dhe kërkesave, jam i bindur që Universiteti i "Nënë Terezës" do të vazhdoj zhvillimin e saj, hapjen e degave studimore të reja si dhe prodhimin e plotë studentave me aftësi për të bërë ndryshime në këtë vend dhe shpresojmë në botë. Në konkludim, besoj që të arrij prestigj mjaft të madh përkrah universiteteve të tjera në rajon.

UNTstudenti: Cilat janë iniciativat dhe arritjet që keni bërë deri tani?

Agon: Arritja më e madhe e deritanishme është hapja e librarisë. Kishte ditë ku shihja studentë të ndryshëm duke kërkuar libra në librari tjera dhe duke përdorur në kohë të lire kabinetet që ishin bosh, për të shfletuar çfarëdo libri që lexonin dhe mendova që, po të kishim mundësi ta hapnim një librari, do rregullonte disa punë automatikisht. Një ndër iniciatorët për hapjen e librarisë të universitetit ishte Profesor, PhD, Bekim Fetaji, ai ishte i pari që iu drejtova me kërkesë të drejtpërdrejtë për hapjen e librarisë. Në fillim edhe pse nuk ishin kushtet, mu dha mundësia që ta kem çelësin e dy kabineteve për ti përdorur si hapësire për lexim jashtë ligjeratave, por eventualisht arritëm deri tek hapja zyrtare e një kabineti të mbushur me material për të gjithë studentet, Sa i përket iniciativave, nga Fakulteti i Shkencave të Informatikes u mbledhëm një grup i vogël studentash (që ishin edhe jashtë Parlamentit Studentor), që t'i mirëmbajmë kompjuterët e kabineteve të cilët përdorën nga ana e studentëve.

UNTstudenti:Kjo po që është një gjë e bukur. Mbase shpresojmë që edhe zëvendësuesit e ardhshëm të juaj ta kenë po të njejtën iniciative.

Agon: Edhe unë shpresoj ashtu, haha.

UNTstudenti: Njejtë si ne edhe universitetet e tjera kanë Parlamentin Studentor të tyre dhe sa i përket kësaj çështje, a ka ndonjë bashkëpunim mes Parlamentit Studentor të tonin dhe të tjerëve ?

Agon: Bashkëpunimet janë të shumta. Momentalisht, njëra prej bashkëpunimeve më të mëdha që e kemi është ajo me Erasmus (që është jashtë tematikës të parlamenteve studentore). Kemi shumë studenta të cilët kanë fituar bursa dhe janë zhvendosur jashtë vendit për studime, në vende sikur Turqija dhe Anglija. Jam i informuar për ata që kanë aplikuar, por nuk kam informata të tjera se a vazhdojnë ende në atë program. Ndërsa sa i përket unioneve të tjera studentore, më shumë kemi bashkëpunuar me unionin studentor të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë. Për tre vite me rradhë, ftesat për konferenca dhe manifestime të ndryshme janë këmbyer gjithnjë me ta. Jemi shoqëruar edhe jashtë "punës". Gjithmonë jemi dhe janë mirëpritur për çfarëdo rasti, por fatkeqësisht kohëve të fundit shkak i angazhimeve nga ana tyre, njejtë edhe nga ana jonë, nuk kemi patur mundësi të bëjmë udhëtime jashtë vendit njejtë si dhe ata. Por ndonëse kemi angazhimet tona, kontaktet janë gjithmonë të hapur me ta. Kemi marrëdhënie shumë të mira dhe shpresoj që të paktën as koha dhe askush mos ta ndryshoj këtë gjë. Po ashtu kemi bashkëpunuar edhe me përfaqësuesit e studentëve shqiptarë të Universitetit "Kiril Dhe Metodij". Tani së fundmi, ishte në plan që të na vizitojnë Universiteti i Prishtinës, po për shkaqe të ndryshme si kollokfiumet nuk u arrit të realizohet vizita, por shpresoj që në të ardhmën e afërt të realizohet një gjë e tillë dhe t'i thellojmë marrëdhëniet edhe me njërin nga universitetet më të mëdha shqipëtare. Bashkëpunime tjera kemi bërë edhe me organizata të tjera jo-qeveritare siç janë Forumi Rinor Shqipëtar, Unioni Studentor Shqipëtar, por nuk ka pasur ndonjë aferë më tepër se vizita si të ftuar të nderit.

UNTstudenti: Më herët the që shpreson që askush mos ti ndryshoj marrëdhëniet me universitetin e "Fehmi Aganit", a mendon që zëvendësuesi yt do të ketë sukses në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e statusit tënd?

Agon: Për studentin e ardhshëm që do të bëhet

kryetar, kam një këshillë. Gabimin që e kemi bërë ne është se kemi mbajtur anonimitet. Studentët kanë qenë në dijeni që Parlamenti Studentor ka ekzistuar, por mund të them që ka qenë si një "shtëpi pa adresë". Studenteve iu duhet ku të adresohen në çdo rast dhe në çdo kohë dhe më vjen pak keq të them të drejtën që nuk kemi qenë në çdo kohë në dispozicion për të gjithë, por gjithmonë janë mbajtur mbledhime me kryetarët e grupëve që ishin ndërmjetësues ndërmjet studentëve dhe neve. Por sidoqoftë shpresoj që gabimet tona të jenë mësim për të tjerët. Gjithashtu ajo që shpresoj është që të paktën të mundësojmë një zyre sa do e vogël për kësi lloj problemesh.

UNTstudenti: Dhe për në fund, a ke ndonjë mesazh drejtuar kujtdo që do e lexonte këtë intervistë?

Agon : Po. Kam dëshirë që studentët e rinj të jenë më aktiv aty ku kemi qenë ne pasiv, të jenë më afër studentave tjerë ose me pak fjalë të jenë të padallueshem nga të tjerët edhe pse kanë detyra dhe përgjegjësi të tjera nga të tjerët. Të krijojnë lidhje që të mund të zgjidhin probleme sa më efikas, që nesër, studentët të kenë tek kush të drejtohen pa turp. Sidoqoftë, gjithmonë shpresojmë që e ardhmja të na ofrojë kohëra më të mira.

unt.edu.mk

contact@unt.edu.mk

+389 2 3161 004



UNT

Intervista me prorektorin e UNT-së prof. dr.Bekim Fetaji

INFORMATIKA NJË FUSHË DINAMIKE QË NDRYSHON ME HAPA TË SHPEJTA

Punoj: Rasim Ajredini



A mund të prezentoheni?

Quhem Bekim Fetaji dhe jam Profesor Ordinar në fushën e Informatikës. Për momentin jam Prorektor për Shkencë pranë Universitetit Nënë Tereza (UNT). Gjithashtu punoj si Profesor pranë Fakultetit të Informatikës të UNT-së. Studimet e doktoraturës i kam përfunduar në Universitetin Teknik të Graz-it në Austri dhe ato të Magjistraturës në Oksford të Anglisë në "Oxford Brookes University", ndërsa studimet deridiplomiket në Shën Kiril dhe Metodij në Shkup. Punoj në arsim dhe edukim më shumë se 20 vite dhe për mua ky është profesion që e respektoj mjaft dhe është i shenjtë për mua dhe ku une e gjej vehten.

Si i filluat hapat e para drejt IT-së?

Hapat e para drejt IT-së dhe Informatikës i fillova që në shkollë të mesme ku isha drejtimi Matematik Informatikë dhe gjithashtu punoja programe për Internet kafete në qytetin tim të lindjes, Gostivar. Përveç për internet kafetë kam programuar edhe shumë aplikacione të ndryshme të cilët kanë qene jo me karakter komercial. Këtu e kisha dalluar aplikacionin "parashikuesi i ardhmërisë" i cili kërkonte dhe në bazë të futjes së një numri nga shfrytëzuesi, aplikacioni pastaj gjeneronte në menyrë random dhe i kombinonte fjalët prej 4 listave të mëdha të hardkoduar dhe krijuar më parë dhe në formë të formë të strofave-verseve poetike me një kombinim unik të fjalëve dhe në këtë menyrë për çdonjërin krijonte nga 3 strofa me nga 4 reshta poema.

Kur e zbuluat që keni pasion për Informatikën?

Informatikën e zbulova që e kam pasion që në shkollë fillore. Një prej shokëve të mi e kishte prindin shumë të pasur dhe atij i kishin blerë në atë kohë kompjutor "Commodore 128" i njohur gjithashtu si C128. Ky është kompjuteri shumë i popullarizuar 8-bitësh që u lëshua nga Commodore Business Machines (CBM) në Janar të viti 1985 në SHBA. Ky shoku na mblidhte në shokët e klasës për vikende tek ai, dhe shumë kohë kemi kaluar në shtëpinë e tij dhe atë vit vendosa të blej edhe unë një. Që ta realizoj këtë ëndër timen vendosa të shkoj verës të punoj në një restorant në Crikvenicë, Kroaci gjatë pushimeve verore. Dhe kështu mbasi u këtheva e bleva "Commodore 64" dhe aty shumë kohë kam kaluar duke programuar në gjuhën GV Basic, paraardhësi i Visual Basic NET të sotshëm.

Çfar keni punuar përpara profesionit si Profesor?

Para profesionit si Profesor gjatë kohës që kam qenë student kam punuar si gazetar për gazetën "Dnevnik" në kryeredaktorin Branko Gervoski në seksionin e teknologjisë së informatikës dhe lajmeve për inovacionet më të reja. Mbas kësaj kam punuar si Profesor në shkollën e mesme teknike në Gostivar dhe me hapjen e Universitetit të Europës Juglindore në vitin 2001 u punesova aty fillimisht si demonstratorë, pastaj si asistent e pastaj më vonë edhe si Docent dhe Profesor në Shkencat Kompjuterike. Më vonë me hapjen e Universitetit Nënë Tereza në Tetovë të vitit 2016 unë kalova në UNT dhe Fakultetin e Informatikës ku jam edhe sot dhe punoj si Profesor Ordinar pranë këtij Fakulteti.

A keni pasur momente kur keni qenë të zgjënjer nga rugetimi i zgjedhur?

Po shpesh edhe unë, besoj si çdo një tjetër në jetë ka sfida dhe momente të rënda ku fusim në pikëpyetje rugëtimin që e kemi bërë. Mbas përfundimit të studimeve të Doktoraturës në Austri unë konkurova për studime të pasdoktoratures në "London Southbank University", Londër të Anglisë dhe të cilët më afruan stipendion vetëm 40%. Më duheshin edhe fonde dhe ndihma të tjera që të mundem të shkoj se harxhimet atje janë shumë të shtrenjta dhe aplikova për ndihme në më shumë institucione. Në atë kohë derisa isha në kërkim të fondeve shtesë më afruan pozitën e Dekanit të Fakultetit të Teknologjive dhe Shkencave Bashkëkohore pranë UEJL-se dhe pranova. Dhe sot ndonjëherë e mendoj a do të ishte ky rugëtim më i mirë të kisha shkuar në Angli në postdoktoraturë në vend që zgjedha pozitën e Dekanit?

Cilët janë tiparet e një studenti të dalluar sipas jush?

Një student i dalluar sipas meje është ai i cili mëson për vehten dhe për të kuptuar esencën e

koncepteve dhe që mundohet në menyrë kreative t'i aplikon ato njohuri në jetën e përditshme. Zakonisht në bazë të eksperiencës time 20 vjeçare studentët më të heshtur dhe më vështrim të parë të tërhequr (ndryshe njihen si student reflektiv) arrijnë suksese mjaft të mëdha.

Si qëndron gjendja e Fakultetit të Informatikës në Universitetin Nënë Tereza?

Fakulteti i Informatikës në Universitetin "Nënë Tereza" u themelua nga njerëz që kishin një vizion. Ky vizion ishte se si informatika do të ketë lidhje të ngushta me matematikën dhe inxhinierinë, por gjithnjë e më shumë ka përjetuar bashkëpunime me disiplina të tjera të rëndësishme për Universitetin, përfshirë statistikat dhe matematikën në përgjithësi, metodologjitë e mësimdhënies, filozofinë, sociologjinë, ekonominë, fizikën dhe disiplina të tjerë. Është përmes këtyre ndërveprimeve me disiplinat tjera që rëndësia e Informatikës mer një kuptim më të gjerë dhe integrohet më së miri si studim interdisciplinar. Programi i Informatikës studentëve të diplomuar do tu ndihmojë në zhvillimin e bazës së fortë në matematikë, programim, koncepteve menaxhuese dhe informatike që kërkohet nga industria dhe që nevojitet për të hyrë në fushën e kërkesës së lartë, gjithnjë në zhvillim dhe ka një përparim dhe ndryshim dinamik. Te studentët fokusi është te aftësitë për zgjidhjen e problemeve, ngrisin aftësinë e tyre të menduarit abstrakt dhe kreativ si dhe zhvillojnë aftësitë e qasjes kreative për të zgjidhur probleme të ndryshme që kërkojnë kreativitet dhe analizë pragmatike. Në këtë aspekt une mendoj se studentët tonë do të arrijnë mjaft suksese kur të punësohen. Gjithashtu çdo studenti i jonë, mbas diplomimit i ngel emaili zyrtar i UNT-se dhe e kanë derën e hapur përgjithmonë dhe kanë qasje te Profesoret dhe asistentët e vet për çdo sfidë që do ketë në punë dhe jetën e tij. Kjo është një përparësi të cilën Universitet tjera nuk e ofrojnë.

Si është të dini që drejtimi juaj ka kapluar botën dhe ju ishit pjesë e saj që nga koha kur mori një hov të madh?

Është një ndjenjë mjaft e mirë të dish se je pjesë e një drejtimi i cili mori një hov kaq të madh në shoqëri dhe të jesh pjesë e saj ndonjeherë e konsideroj si një bekim të punës dhe sakrificës së bërë. Studimi dhe aplikimi i teknologjisë së informatikës në arte, shkencë dhe profesione tjera dhe përdorimi i tij në organizata dhe shoqëri në përgjithësi arriti një përmasë mjaft të madhe.

Informatika është një fushë mjaft dinamike dhe me zhvillim të shpejtë që përdor kompjuterët dhe llogaritjen për të zgjidhur problemet e mëdha në: komunikimet, bizneset, sigurinë, kujdesin shëndetësor, arsimin, varfërinë dhe sfidat në mjedisin tonë. Të gjitha aplikacionet e Informatikës janë të bazuara në kompjuter ose njësi të tij mobile. Këto aplikacione kanë përmirësuar aspekte të ndryshme në fusha të tilla si komunikimi, matematika, multimedia, dhe modelimi i ndërveprimit njeri-kompjuter. Informatika menaxhon dhe analizon të dhënat e mbledhura për të zgjidhur sfidat shkencore në shkencat natyrore dhe shoqërore. Zgjeron të kuptuarit tonë mbi botën, proceset dhe vetë ato të njerëzve. Zhvillon aplikacione kompjuterike që menaxhojnë të dhëna nga bizneset, bashkëpunimet bioteknike dhe farmaceutike dhe midis fushave të ndryshme. Informatika ka gjetur aplikim gati se në çdo fushë shkencore të sotshme dhe se njohuria e bazave të informatikës është bërë kusht për të punuar në të gjitha fushat tjera sot.

FAKULTETET DHE PROGRAMET STUDIMORE NË UNT

Tashmë Universiteti "Nënë Tereza" i themeluar prej katër vitesh, falë përkushtimit të stafit akademik ka arritur besueshmërin e madhe në arsim. Ajo nga viti në vit, arrin që të sjellë risi në sferën e shkencës duke ofruar programe të nevojshme dhe të munguara në tregun e punës. Duke pasur parasysh se vet universiteti ka një perceptim të mirë në vend, interesimi nuk ka munguar. Universiteti "Nënë Tereza", siç ka edhe emrin, është në përpjekje e mësipërme për plotsimin e nevojave të studentëve. Universiteti është i ndarë në 5 fakultete të shpërndara në programe të vyeshme dhe të veçanta në tregun e punës global:

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës - Programet studimore: Arkitekturë dhe dizajn, Ndërtimtari, Gjeodezi dhe gjeo-informatikë me dekan prof.dr. Zekirija Idrizi.

Fakulteti i Shkencave të Informatikës - me programet studimore: Informatikë në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe, Informatikë Mësimdhënie dhe Programim i Aplikuar 3 vjeçar me dekan Prof.Inor.Dr.Aleksandar Dimovski.

Fakulteti i Shkencave Teknike - me programet studimore: Sistemet elektro-energjetike, Inxhinieri makinerie dhe menaxhment, Inxhinieri e komunikacionit dhe transportit, Inxhinieri ekonomike, Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi, Mekatronikë, Dogana, shpedicion dhe sigurime, Inxhinjeri për mbrojtje të punës dhe ambientit me dekan Prof.Inor.Dr.Agim Mamuti.

Fakulteti i Shkencave Teknologjike - me programet studimore: Inxhinieri e materialeve dhe nano-teknologjive, Teknologjia ushqimore, Agroninxhinieria, Tekstil dizanajni dhe modelim me dekan Doc.Dr.Sani Demiri.

Fakulteti i Shkencave Sociale - me programet studimore: Politika sociale dhe puna sociale, Studime evropiane, Media dhe Komunikim Ndërkulturor, Studime Ballkanike dhe Euroaziatike, Sport dhe shkenca sportive, Administrim Publik dhe menaxhim i resurseve humane me dekan Prof.Dr.Sunaj Raimi.

Universiteti 'Nënë Tereza', do ta zgjerojë më tutje programin e saj, duke pasur shumëllojshmëri të mundësive për të studiuar studentët e ardhshëm. Sukseset dhe arritjet janë synimi i të gjithë stafit me të cilën Universiteti 'Nënë Tereza' është i formësuar.



Intervista me dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale - Prof.dr. Sunaj Raimi

Sevdie Ramadani

UNTstudenti: Ju si dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale, si i shihni programet studimore që i ofron Universiteti ynë, a janë të mjaftueshme për tregun tonë apo ka nevojë për prurje të reja?

Dekani: Siç është e ditur, tanimë Universiteti publik 'Nënë Tereza' ka ofruar një lepezë të pasur të Programeve studimore të ndryshme nëpër pesë fakultetet e saj. Për momentin, në Fakultetin e Shkencave Sociale të cilin e drejtoj unë, ekzistojnë gjashtë programe studimore mjaft atraktive tek të cilat zhvillohen veprimtaritë e përditshme arsimore-shkencore, e ato janë: Punë dhe politikë sociale; Media dhe komunikim ndërkulturor; Administrim publik dhe menaxhim i resurseve humane; Studime europiane; Sport dhe menaxhim sporti; Studime ballkanike dhe euroaziatike. Por, tendenca e Fakultetit tonë si dhe e vet Universitetit është që në vitet vijuese ta zgjerojmë ofertën tonë karshi kërkesave të studentëve dhe tregut të punës. Kështu bie fjala, përveç Programeve Studimore ekzistente, në FSHS në proces të akreditimit i kemi edhe dy programe të reja studimore si: Psikologjia e përgjithshme dhe Kujdesi shëndetësor. Shpresojmë që me këto oferta të reja do ta plotësojmë edhe një boshllëk të shqiptarëve të RMV-së përkitazi me studimet universitare të cilat do të jenë konkurente në tregun e punës.

UNTstudenti: Disa programe studimore kanë numër më të madh të studentëve edhe pse nevojat në tregun e punës janë të vogla. Si mendoni pse ndodh ky fenomen? A ndodhë nga pavarësia e studentëve apo lëshim nga Univesiteti p.sh. për mos kufizimin të numrit të kuotave për pranim?

Dekani: Lidhur me këtë pyetje, vlen të theksohet fakti se numri i madh i studentëve në disa Programe studimore ka të bëjë me vendimet personale të studentëve në konsultim me familjarët e tyre, të cilat ne si Universitet dhe Fakultet plotësisht i respektojmë si të tilla. Sipas mendimit tim, numri i madh i studentëve në disa Programe Studimore të Fakulteteve tona nuk ka të bëjë me mosdijen apo mosinformimin e studentëve, por pikërisht me atë se këto Programe studimore siç janë: Puna dhe politika sociale, Sporti dhe shkencat sportive, në gjuhën shqipe në Shkup për herë të parë i ofron Universiteti ynë 'Nënë Tereza', përkatësisht Fakulteti i Shkencave Sociale. Ndërkaq sa i përket kufizimit të kuotave shtetërore për te këto Programe Studimore, konsideroj se tani për tani kjo nuk është ide e mirë, sepse Universiteti 'Nënë Tereza' në Shkup është Universiteti i ri dhe ne akoma nuk kemi ardhur deri në fazën e ashtuquajtur 'hiperproduksioni kuadrovik' në tregun e punës së RMV-së.

UNTstudenti: A mendoni se Universiteti "Nënë Tereza" si Universitet i ri është i aftë të konkurojë me universitetet më të vjetër dhe më me përvojë në Maqedoninë e Veriut?

Dekani: Universiteti 'Nënë Tereza' si Universitet më i ri në RMV, ka telashe të caktuara lidhur me ndërtimin e Kampusit universitar të shumëpritur, realizimi i të cilit po zvarritet nga shkaqet e natyrës administrative-burokratike. Ne shpresojmë se ky Kampus universitar do të ndërtohet në kohë sa më të shpejtë, me çka do të rritej edhe mundësia për cilësi të veprimtarive arsimore-shkencore dhe hulumtuese, e cila Universitetit tonë asnjëherë s'i ka munguar. Lënë modestinë anash, Universiteti ynë ka një staf të



shkëlqyer të profesorëve dhe asistentëve, disa prej të cilëve janë emra të njohur të arsimit dhe shkencës me shumë libra të botuara, si dhe disa të tjerë që kanë bërë studime jashtë vendit, të cilët kanë punime shkencore referente nëpër Revista ndërkombëtare prestigjioze me impakt faktor. Nisur nga këto premisa, konsideroj se me ndërtimin e Kampusit universitar, ku do të kemi amfiteatre, zyre, laboratore dhe pajisje adekuate, Universiteti ynë 'Nënë Tereza' do të jetë plotësisht i gatshëm për të garuar në aspektin cilësor me Univesitetet tjera më të vjetra në RMV.

UNTstudenti: Si janë kushtet në Fakultetin e Shkencave Sociale, a mund te thoni qe janë të kënaqshme sa për t'i tërhequr studentët e ardhshëm që të regjistrohen?

Dekani: Kushtet në të cilat momentalisht zhvillohet mësimi në Fakultetin e Shkencave Sociale janë relativisht të mira, sepse siç e dini, ky Fakultet së bashku me Fakultetin Teknologjik, punon në hapësirat e Sh.F. 'Kongresi i Manastirit', të cilat klasa në përdorim na ka dhënë Komuna e Çairit, derisa të ndërtohet Kampusi universitar për të cilin folëm më lartë. Opinioni i gjerë në RMV është i informuar për këtë punë, por falë përkushtimeve të stafit akademik, administratës dhe të studentëve tanë arsimdashës, ne orvatemi që punët dhe obligimet tona akademike dhe shkencore t'i realizojmë në nivelin më të lartë. Bazuar në profesionalizmin e stafit tonë akademik, të administratës dhe vullnetit të mirë të studentëve tanë, gjykoj se nuk do të mungojë as joshja e ofertave tona për studentët e ardhshëm të UNT-së.

UNTstudenti: Ju si Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale jeni të kënaqur me stafin me të cilin punoni dhe a shihni motiv dhe vullnet nga ana e tyre për punë në këtë Universitet?

Dekani: Unë si Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale, mund të them se deri më tani jam tejet i kënaqur me punën e stafit tim, sepse obligimet dhe përgjegjësitë e secilit Profesor dhe Asistent, janë duke u realizuar në mënyrën e duhur. Kuptohet se kjo gjë nuk do të thotë se ne si staf i FSHS-së duhet të kënaqemi vetëm me këtë punë dhe këto rezultate të arritura, por duhet të orvatemi që të bëhemi edhe më të suksesshëm dhe më atraktiv si për studentët aktual, ashtu edhe për ata studentë të ardhshëm që do regjistrohen në Fakultetin tonë. Me ndërtimin e Kampusit tonë universitar, mendoj se motivimi dhe vullneti për punë do të rritet edhe më shumë, si për Stafin tonë akademik, ashtu edhe për studentët.



Arritjet dhe sukseset e Universitetit “Nënë Tereza” nga dita e hapjes zyrtare e deri sot

Dhjetor 2016 :

1. Marrëveshja e bashkëpunimit mes Universitetit “Nënë Tereza” dhe Universitetit “Fehmi Agani” - Gjakovë
2. Universiteti i Prishtinës i ndan titullin “Honoris Causa” Shën Terezës
3. “Kthimi i Omer Kaleshit”

Shkurt 2017 :

1. Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup organizon Manifestim me temën: “Rrita e arsimit shqip në Shkup”
2. Universiteti “Nënë Tereza” nënshkruajti memorandum mirëkuptimi me kompaninë EVN

Mars 2017 :

1. Rektori Pollozhani priti ambasadorin shqiptarë, Shkëlqesinë e tij, z. Fatos Reka
2. Takim i Rektorit të Universitetit “Nënë Tereza” me Ambasadorin e Hungarisë në Maqedoni
3. Ambasadori i Republikës Islamike të Iranit e vizitoi Universitetin “Nënë Tereza”

Prill 2017 :

1. Ndërkombëtarizimi i Universitetit Nënë Tereza - 19/23 Prill
2. Bashkëpunimi mes Universitetit të Sarajevës dhe Nënë Tereza - 21 Prill
3. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit “Nënë Tereza” dhe Kolegjit Universitar “Bedër” - Tiranë
4. Marrëveshje bashkëpunimi me gjigantin e navigacionit automobilistik “HERE”.
5. Marrëveshje bashkëpunimi me Epokën dhe Universitetin Politeknik të Tiranës
6. Marrëveshje bashkëpunimi me “Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve në Shkup” (I.T.SH.K.SH.)
7. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Isa Boletini” - Mitrovicë

Maj 2017 :

1. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Goce Dellçev” - Shtip
2. UNT bëhet pjesë e platformës kërkimore-shkencore “EBSCO” - 10 Maj
3. Marrëveshje bashkëpunimi mes Universitetit të Nënë Terezës dhe Universitetit Ndërkombëtar të Sarajevës.

Qershor 2017 :

1. Ligjeratë e ambasadorit Francez para studentëve të Universitetit “Nënë Tereza”
2. Delegacioni i ASHA të Kosovës vizitoi UNT-në

Korrik 2017 :

1. Marrëveshje të reja me Universitetet e Kosovës, Gjithmonë e më afër krijimit të hapësirës unike kulturore
2. Profesorë nga Turqia vizitojnë Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup
3. Sporti dhe Shkencat Sportive në Universitetin “Nënë Tereza”

Gusht 2017 :

1. Kryetari i BFI-së vizitoi Universitetin Nënë Tereza

Shtator 2017 :

1. UNT nënshkruajti memorandum bashkëpunimi me ndërmarrjen “Dauti Komerc”
2. UNT organizoi Akademi Përkujtimore për 20 vjetorin e vdekjes së Nënë Terezës

Tetor 2017 :

1. Zëvendës kryeministri Lika vizitoi UNT-në

Nentor 2017 :

1. Prof. Dr. Oliver Schmitt vizitoi Universitetin Nënë Tereza në Shkup

Janar 2018 :


1. Marrëveshje bashkëpunimi në mes UNT-së dhe Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit” - Manastir

Shkurt 2018 :

1. UNT dhe Universiteti “Kadri Zeka” – Gjilan nënshkurajnë marrëveshje bashkëpunimi

Mars 2018 :

1. Studentët e UNT-së fituan çmimin “mYouth award” në “Policy Hackathon Balkan Connect 2018”



● Prill 2018 :

1. UNT në bashkëpunim me QMBN organizoi trajnim për stafin e universitetit
2. UNT marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetin e Korçës
3. Në UNT hapet për publikun Galeria "Omer Kaleshi"
4. OJQ "Legis" në bashkëpunim me UNT-në, organizon debat me temë "Migracioni përmes vizionit të 3 grave"

● Maj 2018 :

1. Garat matematiko-natyrore në Universitetin "Nënë Tereza"
2. UNT dhe Universiteti i Prishtinës nënshkruan marrëveshje të bashkëpunimit

● Qershor 2018 :

1. UNT i ndau titullin Doctor Honoris Causa nobelistit, Dr. Ferid Murad
2. Akademikët Austriak mbështesin UNT-në

● Korrik 2018 :

1. Studentët e UNT-së kthehen me fitore nga "Continental App Camp Europe"
2. Call for papers: 2nd International Conference "Towards Sustainable Development" – TSD2018

● Gusht 2018 :

1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. Arbër Ademi vizitoi UNT-në në ditën e parë të regjistrimit të studentëve

● Shtator 2018 :

1. Në UNT u promovua libri "Naltesimi i Iskanderit"
2. Perspektivat e arsimit në Bashkimin Evropian

● Tetor 2018 :

1. Ministria e Ekonomisë bashkëfinancon parkun teknologjik në Universitetin "Nënë Tereza"

● Nentor 2018 :

1. Programi studimor Media dhe Komunikimi Ndërkulturor në UNT organizoi Mesim Klinik me gazetarin Mr. Agron Vrangalla
2. Në UNT u mbajt konferenca ndërkombëtare TSD 18

● Dhjetor 2018 :

1. Studentët e UNT-së vizituan Drejtorinë e Doganave të Maqedonisë
2. Gazetari i njohur Nazim Rashidi mbajti ligjëratë me studentët e Mediave dhe Komunikimit Ndërkulturor në UNT
3. Universiteti Nënë Tereza në Shkup prezantoi arritjet në përvjetorin e tretë të themelimit të tij
4. Universiteti Nënë Tereza ndau Mirënjohje për bashkëpunëtorët që mbështetën atë që nga themelimi dhe mbajti seminar për stafin administrativ
5. Programi Studimor, Media dhe Komunikim Ndërkulturor organizoi mesim klinik me gazetaren Kadrije Zejnullahu
6. UNT lidh Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Eqrem Çabej" nga Gjirokastra

● Janar 2019 :

1. Studentët e UNT-së do të bëjnë praktikën në kompaninë Uka Komerc
2. Universiteti Nënë Tereza në Shkup zhvilloi Takim Përkujtues dedikuar viktimave të Holokausit
3. Pollozhani dhe Buxhaku nënshkruan Memorandum bashkëpunimi mes Universitetit Nënë Tereza në Shkup dhe Qendrës për Menaxhim me kriza

● Shkurt 2019 :

1. Prof. dr. Venelin TERZIEV zhvilloi ligjëratë para studentëve të UNT-së lidhur me përvojat bullgare para, gjatë dhe pas anëtarësimit në BE
2. UNT nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës
3. Rektori Pollozhani takoi ambasadorin Italian Carlo Romeo
4. Rektori Pollozhani zhvilloi takim pune me Ambasadorin e Hungarisë në Shkup, Lazlo Istvan Dux
5. Profesori i UNT-së Bekim Fetaji ligjroi në Staffordshire të Britanisë së Madhe

● Mars 2019 :

1. Studentë të UNT-së vizituan Njësinë për Punë Sociale pranë Komunës së Çairit
2. UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" NË SHKUP NËNËSHKROI MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME SH.A. POSTAT E MAQEDONISË
3. Universiteti „NËNË TEREZA“ në Shkup nënshkroi memorandum për bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Ambientit Jetësor
4. Në UNT u promovua libri "Fitorja Diplomatike", i prof. dr. Sabri Kiçmari
5. Në UNT u promovua libri universitar "SOCIOLINGUISTIKA" i prof. dr. Mustafa Ibrahim

● Prill 2019 :

1. Fakulteti i Shkencave të Informatikës shënoi Ditën e Kreativitetit
2. UNT morri pjesë në Panairin e Bizneseve dhe të Universiteteve, e organizuar nga Qendra Shkollore e Autokomunikacionit "Boro Petrushevski"
3. UNT SHËNOI DITËN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË INFORMATIKËS "AL-HUARIZMI"

● Maj 2019 :

1. UNT BOTOI VËLLIMIN E TRETË TË REVISTËS SHKENCORE 'SEEJSD'
2. Universiteti 'Nënë Tereza' në Shkup zhvilloi Konferencën shkencore 'Migrimi, mobiliteti dhe mirëqenia sociale në kontekstin e integritimit euro-atlantik'
3. Aktiviteti "PEACE LETTERS"
4. STUDENTËT E DIZAJNIT DHE MODËS DEFILUAN NË SHESHIN KRYESOR TË SHKUPIT
5. Studentët e UNT-së mysafir në ALSAT-M
6. STUDENTËT E UNT-SË VIZITUAN KOMPANINË PËR PRODHIM TË UJIT TË AMBALAZHUAR "MAYA" NË DIBËR

● Qershor 2019 :

1. GJENERATA E PARË E APSOLVENTËVE TË UNT-SË HODHI KAPELAT
2. NË UNT U PREZANTUA KONCEPTI QEVERITAR 'NJË SHOQËRI PËR TË GJITHË'
3. UNT PREZANTOI PROGRAMIN ERASMUS PLUS

● Korrik 2019 :

1. UNT fitoi projekt nga NATO

● Gusht 2019 :

1. UNT do të promovojë librin – 'E kam në zemër popullin tem shqiptar – Bisedime me Shën Nënë Terezë' të autorit Monsinjur Dom Lush Gjergji
2. Profesori i UNT-së prof. dr. Bekim Fetaji zhvilloi ligjeratë në Konferencën e 8-të ndërkombëtare për teknologjitë e përparuara në Sarajevë
3. Rektori Pollozhani i takua me ekspertin spanjoll të turizmit Prof. Dr. Alfonso Vargas
4. Komuna e Çairit i jep në dispozicion UNT-së hapësira për veprimtari arsimore
5. Një delegacion i Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, sot morri pjesë në ceremoninë e shënimit të 109 vjetorit të lindjes së nobelistes shqiptare Gonxhe Bojaxhiu- Shënjtore Nëna Terezë

● Shtator 2019 :

1. UNT THELLON BASHKËPUNIMIN ME UNIVERSITETIN E PRISHTINËS
2. Doc. Dr. Stojan Kitanov vizitoi Universitetin e Klagenfurtit në Austri
3. Projekti eVIVA sot u prezantua para një grup studentësh në Universitetin Nënë Tereza nga koordinatoreja Dr. Diturije Ismaili
4. Studentët e UNT-së ndër 10 më të mirët në Programin Erasmus+ në Bullgari

● Tetor 2019 :

1. UNT ZHVILLOI KONFERENCËN E TRETË NDËRKOMBËTARE "DREJT ZHVILLIMEVE TË QËNDRUESHME" ME NUMËR REKORD PJESËMARËSISH
2. Profesorë nga universiteti hungarez 'Obuda' ligjëruan në UNT
3. Profesori i UNT-se Prof.Dr. Bekim Fetaji ligjëroi në Universitetin Bashkent të Turqisë
4. Studentë të UNT-së që qëndrojnë në dy universitete turke në kuadër të programit Erasmus+
5. UNT nënshkroi Memorandum bashkëpunimi me Sh.A. MEPSO

● Nentor 2019 :

1. STUDENTË TË UNT-SË VIZITUAN PANAIRIN E LIBRIT NË TIRANË
2. UNT me rastin e Ditës Botërore të Shkencës organizoi kurs praktik në Bioinformatikë
3. NË UNT PËRFUNDOI ME SUKSES KURSI PRAKTIK NJËJAVOR PËR BIOINFORMATIKË
4. NJË DELEGACION I UNT-SË VIZITOI UNIVERSITETIN NË KEÇKEMET TË HUNGARISË
5. UNT ME SEMINAR SHËNON DITËN BOTËRORE TË SHKENCËS
6. UNIVERSITETI 'NËNË TEREZA' NË SHKUP ZHVILLOI SEMINARIN E DYTË SHKENCOR NDËRKOMBËTARË MBI INTERKULTURALIZMIN

● Dhjetor 2019 :

1. UNT NË MBËSHTETJE TË FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA TËRMETI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
2. UNT PROMOVON TALENTËT E RINJ



Mbrojtja e ambientit jetësor nëpërmjet aplikacionit "APPLINKA"



Endrit Rushiti student i Fakultetit të Shkencave të Informatikës pranë UNT-së fitoi dy çmime ndërkombëtare nga krijtaria e aplikacionit të tij "Applinka". Ky aplikacion filloi me një "Hackathon" të organizuar nga Fondi Evropian i Ballkanit ku idea e studentit të UNT-së doli fituese dhe u prezantua në Salzburg të Austrisë, rrugëtimi i këtij aplikacioni ka zgjatur gati një vit ndërsa kodimi përafësisht një muaj, ku deri më tani është instaluar nga 400 persona përdorues nga vende të ndryshme si Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, India, Rusia etj.

Aplikacioni "Applinka" lejon përdoruesit të krijojnë një sfidë me disa aktivitete që do ketë ndikim në ruajtjen e ambientit siç janë: ecja, vrapimi, reciklimi, mbjellja e pemëve, pastrimi i parqeve dhe ambienteve publike, socializimin e njerëzve si dhe mban trupin shëndetshëm. "Applinka" poashtu përmban disa veçori të tjera, siç është shpërblimi i cili ka për qëllim që në përfundim të sfidës, humbësi i asaj sfide duhet t'i dhurojë shpërblimin fituesit, si dhe renditjen se kush ka kryer më shumë aktivitete mbrenda shtetit, shokëve dhe në mbare botën.

Endriti thekson që beson fuqishëm se "Applinka" është dhe do të jetë një ndër idetë më kreative, edhe pse nuk është i kënaqur nga

rezultatet e deritanishme, jo nga idea e aplikacionit por nga mungesa e vetëdijësimit të njerëzve për ndotjen e ambientit që është një rrezik shumë i madh, që gati mund të vijë deri në shkatërimin e çdo individi në këtë planet nëse nuk ndërmirret diçka.

Porosinë që na i drejton të gjithëve Endriti është:

“Të ruajmë ambientin, të ruajmë planetin tonë ose përndryshe ju dhe të gjithë ne do të mbetemi thjesht histori. Punoni drejt ëndrrave tuaja sado të pamundura të duken ato. Ëndrrat bëhen gjithmonë realitet nëse ju punoni drejt tyre. Punoni besoni dhe jeni faleminderues!”

Çfarë është aplikacioni "Applinka" dhe si funksionon i njëjti?

- "Applinka" është një aplikacion i cili ka për qëllim mbrojtjen e ambientit. Aplikacioni lejon përdoruesin të krijoj një sfidë me një aktivitet që do të ketë ndikim në ruajtjen e ambientit siç janë: ecja, vrapimi, reciklimi, mbjellja e pemëve, pastrimi i parqeve dhe ambienteve publike etj. Pasi të zgjidhni aktivitetin, përdoruesi duhet të vendos një përshkrim të sfidës dhe një shpërblim për fituesin (shpërblimet mund të jenë: kafe, darkë, shëtitje, shkëmbim i rrjeteve sociale etj.). Qëllimi i shpërblimit është që në përfundim të sfidës, humbësi i asaj sfide duhet t'i dhurojë shpërblimin fituesit. Aplikacioni poashtu përmban disa veçori tjera si renditjen se kush ka kryer më shumë aktivitete mbrenda shtetit tuaj, mbrenda shokëve si dhe në gjithë botën. Poashtu aplikacioni "Applinka", të lejon të shohësh pikat e dobëta të shokëve tuaj dhe t'i sfidosh pikërisht në ato aktivitete që ato kanë të kryera më pak.

Cili ishte qëllimi i krijimit të këtij aplikacioni dhe çfarë e bën unik këtë aplikacion?

- Qëllimi kryesor i aplikacionit "Applinka" është ruajtja e ambientit por njëashtu aplikacioni bën socializimin e njerëzve dhe mban trupin tuaj të shëndetshëm. Një ndër gjërat më unike që posedon aplikacioni është pikërisht vete ideja, ku në një aplikacion të vetëm zgjidhen tre problemet kryesore të shoqërisë tonë.

Sa kohë ju duhej dhe sa e vështirë ishte të krijohet ky aplikacion?

- Rrugëtimi i aplikacionit "Applinka" filloi me një "Hackathon" të organizuar nga Fondi Evropian i Ballkanit.

INTERVISTË

Aty ideja arriti të dalë fituese dhe në kuadër të kësaj ideje u prezentua edhe në Salzburg të Austrisë. Rrugëtimi i "Applinkes" ka zgjatur gati 1 (një) vit ndërsa kodimi i aplikacionit ka qenë përafërsisht 1 (një) muaj.

Sa rezultate ka pasur ky aplikacion dhe si ka ndikuar në shoqëri?

- Realisht nuk jam shumë i kënaqur nga rezultatet e deri më tanishme. Është shumë e vështirë t'i bësh njerëzit të vetëdijshëm për diçka që nuk është e shikueshme, por ndotja e ambientit është një rrezik shumë i madh që gati mund të vijë deri në shkatërrimin e çdo individi në këtë planet, nëse nuk ndërmirret diçka. Këtu nuk është në pyetje idea e aplikacionit por këtu mungon vetëdijësimi i njerëzve rreth këtij rreziku. Pavarësisht kësaj unë besoj fuqishem se "Applinka" është dhe do jetë një ndër idetë më kreative!

Përdoruesit e të cilit vend kanë qenë dhe janë më të interesuar që ta shkarkojnë aplikacionin dhe sa përdorues deri më tani e kanë shkarkuar dhe e përdorin aplikacionin në fjalë?

- Momentalisht përdoruesit më të shumtë janë përdorues nga Ballkani, nga shtetet si Shqipëria, Maqedonia Veriore, Kosova etj, duke cekur faktin se ka filluar të përdoret edhe nga individ në shtetet si Rusia dhe India. Deri më tani është instaluar nga afërsisht 400 persona. Po mundohem që "Applinka" të krijojë një grup të mirë organizuar dhe të vetëdijshëm për fuqinë e idesë, të cilët me aktivitetet e tyre do e promovojnë aplikacionin.

Sa kontriboi UNT-ja në financimin, mbështetjen dhe promovimin gjatë procesit të krijimit të aplikacionit?

- Meqë ideja lindi nga kompeticionet që morëm pjesë në fillim ne ishim më shumë anëtarë të cilët dua edhe ti faleminderoj: Jeton Mustafa, Axhi Beqiri, Lirim Demiri dhe Arianit Deda, të cilët poashtu janë student të UNT-së.

Kemi pasur përkrahje edhe nga profesorët por posaçërisht dua të faleminderoj profesoreshën Majlinda Axhiu e cila ka qenë pjesë e idesë nga fillimi.

Sa është shoqëria jonë e informuar, e aftë dhe aktive në përdorimin e teknologjive dhe a mendoni se shoqëria jonë nuk i shfrytëzon maksimalisht mundësit bashkëkohore teknologjike?

- Në këto kohë, sa i përket botës së teknologjisë të gjithë njerëzit jemi të njejtë, dallojmë vetëm në aspektin se si e përdorim teknologjinë. E kam cekur gjithëmonë se ne gjithmonë kemi patur një shoqëri të aftë dhe punëtore, jo vetëm në aspektin e teknologjisë por gjithëandëj. Arsyeja e vetme, se përse nuk dëgjojmë shpesh për njerëzit e suksesshem të shoqërisë tonë është socializimi. Mendoj se na mungon organizimi dhe socializimi!

Cila është porosia e juaj për shoqërinë tonë veçanërisht për rininë?

"Të ruajmë ambientin të ruajmë planetin tonë ose përndryshe ju dhe të gjithë ne do të mbetemi thjesht histori."



Aktivitetet e organizuara në UNT gjatë vitit 2019

Universiteti Nënë Tereza organizoi shumë aktivitete dhe konferenca të ndryshme gjatë këtij viti akademik, të cilat u realizuan me një arritje mjaftë të suksesshëm dhe të mirëpritur. UNT-ja mbajti aktivitete të ndryshme të cilat kanë përfshirë të gjitha Fakultet e mundshme të UNT-së. Në aktivitetet e UNT-së nuk ka pasur organizime vetëm nga ana e profesorëve por edhe nga vetë studentët e sajë. Në vijim do ti cekim disa prej aktiviteteve që janë organizuar nga UNT-ja.



02 Prill - **Dita Botërore e Autizmit** - u mbajtë një organizim mjaftë interesant dhe mesazhlënës në zemër të Shkupit, në Çarshinë e Vjetër, e organizuar nga studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup. Eventi që u zhvillua në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit, përfshiu aktivitete informativo - senzibilizuese të organizuara nga studentët. Qëllimi i eventit ishte të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin në drejtim të autizmit dhe të kremtojë ndryshueshmëritë mes njerëzve përmes aktiviteteve të shumëllojshme. Ky event si synim kishte pranimin dhe përfshirjen e personave autik mes nesh, pasi që ata nuk kanë asgjë ndryshe nga ne përpos aftësive të veçanta. Ata bëjnë pjesë në familjet tona, në komunitetin tonë dhe në shoqërinë e gjërë. Le të krijojmë një shoqëri e cila do të vlersojë talentet dhe dhuntitë unike, le të jemi ata të cilët



11 Maj - **Konferencë shkencore " Migrimi, mobiliteti dhe mirëqenia sociale në kontekstin e integritit euro-atlantik "** - Në të cilën kontribut të tyre dhanë ekspertë nga vendi, Austria, Gjermania, Spanja, Irani, Kosova, Shqipëria dhe Turqia. UNT-ja ka bërë studim me studentët e të tre universiteteve, të UNT-së, USHT-së dhe UEJL-it, dhe përmes këtij studimi është arritur deri tek përgjigjet dhe arsyet më të shumta se pse të rinjtë marrin vendim për të lëshuar vendin, duke shtuar se ky studim rasti do të jep kontribut në parandalimin e këtij fenomeni.

progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e Kriteve të Kopenhagës, i " dhanë " datë për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Qëllimi kryesor i dhënies së datës, sipas studentëve, ishte parandalimi i ikjes së të rinjve nga vendi. Sipas roleve, në tryezën e rrumbullakët një student përfaqësonte një shtet anëtar, ndërsa në tavolinën kryesore u simulua presidenti i Këshillit Evropian Donald Tusk, ai i Komisionit Evropian Zhan Klod Juncker dhe përfaqësuesi i Rumanisë, e cila ka presidencën e BE-së, ndërsa vendimin e tyre e priste Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, i cili i'u përgjigj pozitivisht ftesës së studentëve të UNT-së, që të merr pjesë në këtë simulim.



14 Maj - "Dhënia" e datës për fillimin e negociatave - Aktiviteti i studentëve të UNT-së, Programi Studimor Studimet Evropiane, në kuadër të muajit evropian, e organizuar nga profesoresha Drenusha Kamberi u mbajt "Simulimi i Samitit të 20 dhe 21 qershorit 2019, të Këshillit Evropian", me ç'rast pas diskutimit mbi



15 Maj- **Dita Ndërkombëtare e Familjes** - Fakulteti i Shkencave Sociale në bashkëpunim me Asociacionin për Afirmimin e Gruas organizoi panel diskutimi me kryetëmë: " Sfidat e Familjes Shqiptare në periudhën e transformimeve ". Aktiviteti u organizua dhe moderua nga profesoresha Elisabeta Ollogu, e ndërkaq panelistë të pranishëm ishin: Prof. Dr. Arafat Shabani, dekan i Fakultetit të Gjuhëve, Kulturës dhe Komunikimit pranë Universitetit të Evropës Juglindore i cili trajtoi temën: "Agenset e socializimit të familjes shqiptare në periudhën e tranzicionit". Gjithashtu pjesë e panelit ishin edhe profesorët Sunaj Raimi me temë: "Transformimet e familjes shqiptare në periudhën e tranzicionit" dhe profesor Avni Avdiu me temën: "Dilemat e prindërimit bashkëkohor". I gjithë aktiviteti u mbyll me thënien e famshme të humanistes Nënë Tereza – "Nëse dëshironi të punoni për paqen në botë, shkoni në shtëpitë tuaja e duajini familjet tuaja".



12 Qershor - **Ekspozita Vjetore** - nga Arkitektët e ardhshëm, studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë, pranë UNT-së, sot prezentuan punimet e tyre, të cilat ishin të ekzozuara në Qendrën Kulturore Informative në Shkup. Ekspozita trajton fenomenet dhe konceptet aktuale socio-kulturore, arkitektonike, përmbajtësore, ekologjike dhe urbane të paraqitura përmes projekteve të punuara nga studentët përgjatë këtij viti akademik. Projektet tregojnë konceptet bashkëkohore arkitektonike, urbane dhe zgjidhje për lokacione të ndryshme në territorin e Shkupit dhe më gjërë, do të jenë interesante dhe frymëzuese për studentët, arkitektët dhe publikun e gjërë. Me këtë, punimet e studentëve zgjuan interes të madh nga pjesëmarrësit në këtë event, si dhe të ftuarit në këtë organizim. UNT në këtë mënyrë ka për qëllim nxitjen, pjesëmarrjen dhe interesin e shtuar të publikut dhe mediave, me çka ekspozita do të marrë karakter interaktiv dhe do të hapet mundësia për komunikim dhe prezentim të veprave të studentëve me publikun.



29 Maj - **Defilim " Dekonstruktimi i Ndriçuar" (Illuminated Deconstruction)** - Defilimi, filloi nga Rektorati i UNT-së, vazhdoi nëpër " Parkun e Gruas " dhe përfundoi në Sheshin e Shkupit. Studentët që kishin veshur kreacionet e tyre parakaluan nga Porta e Maqedonisë së Veriut, ndërsa prezantimin përfundimtar - performancën e zhvilluan rreth Monumentit në Sheshin kryesor. E gjithë ngjarja u përcjell nga kalimtarët e rastit dhe turistët, tek të cilët ky paradim nxiti vëmendje, parashtruan pyetje dhe realizuan fotografi me studentët. Gjatë eventit u lëshuan video dhe fotografi përmes mediave sociale, të ndjekur nga më shumë se 10,000 pasues. Kostumet janë bërë nga studentët e drejtimit 'Tekstil, Dizajn dhe Modelim', në Fakultetin e Shkencave Teknologjike pranë UNT-së. Në defilim morrën pjesë 20 studentë, si dhe studentë me kohë të pjesshme të modës. Parada mundësoi zhvillimin e një shprehjeje të re të performancës së lëvizjes së qendrës së qytetit.



28 Qershor - **Kampioni Evropian i mundjes Besir Alili** - student i UNT-së, në programin studimor Sport dhe Shkenca Sportive, në emër të UNT-së Rektori i ndau mirënjohje kampionit evropian Besir Alili, me motivacionin si krenaria dhe fisnikëria e rinisë në vendin tonë, duke dëshmuar se vetëm me punë, përkushtim dhe disiplinë arrihet te suksesi i kërkuar, ndërsa Kryetari i Senatit të UNT-së i ndau disa dhurata kampionit evropian dhe klubit Liria duke u premtuar që së bashku me Rektoren, studentët e sportit dhe përfaqësues tjerë të UNT-së do të vijjnë në vizitë akademike dhe profesionale

të talentëve të rinj. Me këtë rast edhe vet kampioni, Besiri Alili, shprehu mirënjohjen për mikëpritjen e bërë nga ana e Rektoratit dhe stafit akademik pa anashkaluar dhe studentët e sportit, duke theksuar gëzimin për respektin dhe përkrahjen e vazhdueshme që po i ofrohet si kampion. Ai poashtu premtoi se falë suksesit të arritur, rriten edhe ambiciet e tij, për të qenë në pedestal edhe në kampionat botëror, por edhe në olimpiada, për të cilat pedestale vetëm se ka filluar edhe përgatitjet.



26 Qershor - **109 vjetorit i lindjes së Nobelistes shqiptare Gonxhe Bojaxhiu** - Nëna Terezë - Një delegacion i UNT-së u zhvillua nën organizim të Institutit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror të Shqiptarëve në Maqedoni. Nobelistja shqiptare Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Terezë ka lindur më 26 gusht 1910 në Shkup, që nga mosha e saj 18 vjeçare kur ajo la Shkupin ku lindi, tërë jetën e saj ia kushtoi çështjes së bamirosisë, duke i ndihmuar familjet e varfëra dhe personat e sëmurë, anë e mbanë botës, me theks të veçantë Indinë. Nëna Terezë ndërroi jetë më 5 shtator 1997. Për vlerat e saja jetësore, Nënë Terezë, Vatikanit e shpalli Shënjtore. Universiteti ynë me krenari e mban emrin e saj.



27 Gusht - **Konferencën e 8-të ndërkombëtare për teknologjitë e përparuara ("8th International Conference on Advanced Technologies (ICAT'19)** - Profesori i UNT-së Prof. Dr. Bekim Fetaji gjatë vizitës së punës në Sarajvë të Bosnjë e Hercegovinës, në cilësinë e përfaqësuesit të UNT-së zhvilloi ligjeratë në Konferencën e 8-të ndërkombëtare për teknologjitë e përparuara. Me këtë rast Profesori Fetaji mbajti ligjeratën e tij të titulluar:

" Programimi në Shkencën e të Dhënave dhe Analizat e Perspektivave të Parashikimit të Diabetit dhe Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor ". Qëllimi kryesor i ICAT'19 është prezantimi i hulumtimeve shkencore dhe rezultateve më të fundit të shkencëtarëve në lidhje me Informatikën dhe shkencat kompjuterike, elektroteknikën dhe elektronikën, teknologjitë e ndryshme, mekatronikë dhe teknologji biomjekësore. Kjo konferencë ofron mundësi për shkencëtarët e zonave të ndryshme për të shkëmbyer ide të reja dhe përvoja të aplikimit ballë për ballë, për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi ose hulumtimi shkencor dhe për të gjetur partnerë globalë për bashkëpunim në të ardhmen në projekte të përbashkëta.



19-30 Gusht - **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare** - u mbajt në kryeqytetin kosovar, Profesori i UNT-së Prof. Dr. Mustafa Ibrahim në paraqitjen e tij prezatoi "Varietet në të folmen shqipe të Prilepit dhe Krushevës më parë dhe sot", që zgjoi interesim të veçantë në Seminar. Njoftoi të pranishmit me vendodhjen e popullsisë shqiptare në këto dy qytetete, e cila në rrethinat e Prilepit është e pranishme në gjashtë fshatra Cërnilishtë, Desovë, Llazhan, Debresht, Peshtalevë dhe Gostirazhni, ndërsa në rrethinat e Krushevës është e pranishme në tetë fshatra Zhitoshë, Presill, Alldançe, Nerovë, Jakrenovë, Bellushinë, Borinë dhe Sazhdovë. Bazuar në provat e parashtruara mund të nxirret një konkluzion se gjuha shqipe e folur në rrethin e Prilepit dhe Krushevës ka të bëjë me grupin qendror të dialektit Gegë. Por ky reflektim dialektik përfshin edhe segmentet fonetike, morfologjike dhe leksikore që lidhen edhe me dialektin Toskë. Nga një perspektivë komunikuese ndërshqiptare, e folmja shqipe e Prilepit dhe Krushevës janë të folme të izoluar në krahasim me folësit e tjerë shqiptarë në Maqedoni. Kështu, ky idiom ka risitë e veta unike që nuk mund të gjenden në asnjë gjuhë tjetër të folur shqiptare, për shembull: diftongimi i y > (ay); disa ndryshime të përemrat e pacaktuar: ceri, cëra, cërat (<cili, cila, cilat, cilët); shumësi duke shtuar prapashtesën -inja (fletorinja, shishinja, magarinja). E njëjta gjë ndodhi me fjalët të tjera leksikore



03 shtator - **Seminarin tradicional me stafin akademik, i cili këtë vit shtjelloi temën: "Përvojat, sfidat dhe vizionet për zhvillimin e programeve të studimit"**. - Fjalë hyrëse në seminar mbajti rektori i UNT-së prof.dr. Aziz Pollozhani, ndërsa i ftuar i posaqëm ishte akademik Vlado Kambovski. Pjesë e panelit ishin profesorët e UNT-së Bekim Fetaji, Zoran Trifunov dhe Bashkim Ziberi. Rektori Pollozhani u ndal në temën " Programet studimore të UNT-së dhe reaktitetimi i tyre, vizioni për universitet modern dhe të suksesshëm " ku para të pranishmëve theksoi nevojën e ndërmarrjes së reformave në sferën e arsimit të lartë, për ti kundërvuar uljes së vazhdueshme të numrit të studentëve në të gjitha universitetet në vend, si dhe gjetjen e mënyrave për stimulimin dhe rritjen e numrit të studentëve të shkencave teknike, që përbëjnë numrin më të vogël të studentëve aktualë. Në seminarin me temë " Përvojat, sfidat dhe vizionet për zhvillimin e programeve të studimit " morrën pjesë i gjithë stafi akademik i UNT-së.



08 Nëntor - **Seminari i dytë shkencor ndërkombëtarë mbi Interkulturalizmin** - në Galerinë 'Omer Kaleshi', Universiteti 'Nënë Tereza' në Shkup zhvilloi Seminarin e dytë shkencor ndërkombëtarë mbi Interkulturalizmin, me temë: Trashegimia Kulturore dhe Interkultura si Udhërfyes i Integritimit dhe Kohëzimit Social, "Multikulturalizmi dhe Dialogu Interkulturalor ", Mysafir nderi në seminar është ministri i Kulturës Hysni Ismaili, i cili së bashku me Rektorin e UNT-së Prof. Dr. Aziz Pollozhani kishin fjalë hyrëse në seminar.



16-17 Nëntorë - Studentët e UNT-së zhvilluan panairin e librit në Tiranë - Nën organizimin e Unionit të Parlamentit Studentor, studenti Bajram Ramadani me një grup studentësh të Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, gjatë fundjavës vizituan edicionin e 22-të me radhë të Panairit të librit në Tiranë, i cili mbledhë në një vend botues nga të gjitha trevat shqiptare. Studentët nga Fakulteti i Shkencave të Informatikës, Shkencave teknike, Shkencave Sociale dhe Teknologjike u organizuan me qëllim të informimit me titujt më të rinj të botuar nga Tirana, po secili mori aq libra sa kishte nevojë, apo pse jo edhe mundësi. Organizatori i vizitës së Panairit të librit në Tiranë, student i vitit të katërt në Fakultetin e Shkencave të Informatikës, Bajram Ramadani, thotë se në Tiranë do të kthehen sërish, por se aktivitetet e studentëve do të shtrihen edhe në shtete tjera dhe universitete me të cilat UNT ka bashkëpunim.



25 Tetor - **Konferenca Ndërkombëtare me temë "Drejt zhvillimit të qëndrueshëm"** - Për të tretën herë me radhë UNT-ja, zhvilloi Konferencën ndërkombëtare me temë "Drejt zhvillimit të qëndrueshëm", ku pjesëmarrës ishin ministra, deputetë, rektorë, profesorë si dhe ekspertë të njohur të fushës nga Shqipëria, Kosova, Kroacia, Hungaria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania dhe Japonia. Qëllimi i konferencës është gjetja dhe shfrytëzimi i resurseve plotësuese për një zhvillim më të qëndrueshëm, dhe si rrjedhojë krijimi i kushteve për një shoqëri më të zhvilluar dhe jetë më të mirë të qytetarëve. Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillim që adreson nevojat e të tashmes pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme që të mund të adresojnë nevojat e tyre. Temat që u shtjelluan në konferencë ishin ekonomia, ekologjia dhe planifikimi hapësinor, edukimi dhe shkenca, dhe teknologjitë për informim dhe komunikim.



26 Nëntor - **Telegram Ngushëllimi dhe Solidariteti** - Dridhjet e tërmetit në Shqipëri që akoma po ndjehen, dridhen dhe vazhdojnë të lëndojnë zemrat tona. Stafi akademik, administrativ si dhe studentët e UNT-së bashkëndajnë dhimbjen me kolegët tanë, profesorë akademik dhe studentë si dhe gjithë popullin shqiptarë. Me mendje dhe lutje jemi me ju, me shpresë që numri i viktimave dhe të lënduarve të jetë sa më i vogël.



Karatisti me dhjetra herë kampion i RMV-së

Punoi: Sabir Xhemaili

Fahik Veseli, djaloshi 18 vjeçar nga Shkupi si dhe njëkohësisht studenti i Universitetit "Nënë Tereza" ka shkruar histori për sportin e Karatesë në vendin tonë.

Për ata që nuk ju njohin, kush është Fahiku?

- Unë jam Fahik Veseli, i lindur më 10 janar të vitit 2001 në qytetin e Shkupit, më saktësisht në një fshat në rrethinën e Shkupit i quajtur Lisiçe, dhe aktualisht banoj aty. Shkollën fillore e kam kryer në shkollën "Liria" ndërsa shkollën e mesme në "Metodi Mitrovski – Brico", gjimnazi sportive. Aktualisht po vazhdoj ti ndjekë studimet në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup.



Në vedin tonë dominojnë sportet kolektive ku më të njohura janë si

futboli, hendbolli, basketbolli, çka ju shtyu juve të zgjidhni karatenë?

- Për dallim nga sportet tjera, sportet individuale çdo herë më kanë pëlqyer më shumë, posaçërisht ato luftarake. Kjo dëshirë për sportet luftarake më ka lindur si fëmijë, ku shihja shumë filma që kanë të bëjnë me sportet luftarake, si çdo fëmijë edhe unë dëshiroja të bëhesha një ditë sikur ato, edhe pse në fillim kur zgjedha karaten ishte ndoshta "rrezik", por gjithmonë kam pasur mbështetjen dhe përkrahjen e familjes posaçërisht nga ana e babit, i cili ka dashur që të kem suksese dhe të jem profesionist e jo të ngeli vetë një sportist rekreativ, dhe besoj që e kam arritur.

Cilat janë hapat e tua të para në lidhje me karatenë?

- Unë me karaten kam filluar që nga mosha 5 vjeçare në klubin "Olimpik" ku dhe ende vazhdoj të jem pjesë i këtij klubi, që më kanë pranuar dhe mbështetur që nga dita e parë dhe nuk më kanë dalluar aspak nga shokët e tjerë edhe pse jam i vetmi shqipëtarë pjesë e këtij klubi.

Keni ndonjë karatist që gjithmonë e keni përcjellur dhe jeni munduar të shkoni pas hapave të tij?

- Po, si çdo sportist që ka një shembull edhe për mua është një karatist nga Azerbejxhani Rafael Aghayev. Ai ka shkruajtur histori për vete me sukseset e tij si dhe për karaten në përgjithësi, rezultatet që ka arritur ti bëj ai deri më sot, nuk ka mund të bëj asksush, shembull 13 herë ka qenë kampion Europe, si dhe shumë suksese tjera në skenën evropiane dhe botërore.

Një sport individual si karateja kërkon shumë stërvitje, na flisni pak në lidhje për stërvitjet e juaja?

- Sa i përket ushtrimeve në momentin që nuk kam kampionate apo turne ku do të duhet të jem pjesëmarrës, që ne në karate e quajmë pauzë aktive ushtroj çdo ditë nga një orë, për dallim nga pauza aktive në momentin që jam i fokusuar në ndonjë garë madhështore, filloj punën dhe përgaditem në myrë profesionale, bëj 60 orë ushtrime në javë, që i bie 3 orë në dite.

Zakonisht në sportet luftarake raporti me trajnerin duhet të jetë në nivel, si janë raportet juaja me trajnerët?

- Unë kam fatin që kam dy trajnerë njëkohësisht dhe i falenderoj shumë, Aleksander Kuzmanovskin dhe

INTERVISTË

Hristijan Mlladenovskin që njëkohësishtë janë dhe trenerët e klubit, të jem i sinqertë që me të dy kam raporte të shkëlqyera, të dy më shumë më ndihmojnë për pjesën taktike, ndërsa për forcën fizike përgaditem me Ferat Kërbliqin i cili ka qenë poashtu një karatist i shkëlqyer.

Po kalojmë tek pjesa e suksesëve ...Të flasim pak për sukseset e tua ne vëndin tonë si dhe skenën evropiane?

- Dëshira e çdo sportisti është të flasë për suksesët dhe të ariturat e tij, pas një medalje apo trofeu të ngritur në qiell qëndron djersë, gjak dhe shumë mund. Sa i përket suksesëve në vëndin tonë, jam 10 herë kampion shtetërorë për herë të pare këtë e kam arritur si 9 vjeçarë, poashtu në vitin 2018 u përzgjodha sportisti i vitit për nga të gjithë të rrinjtë, si dhe jam reprezentues i Maqedonisë së Veriut tashmë 10 vite. Me punë dhe ndihmë nga Zoti kam arritur të korri edhe disa suksese evropiane. Në vitin 2015 u rëndita i pesti në Kampionatin Botërorë që u zhvillua në Xhakarta të Indonezisë, vitin e kaluar isha nënkampion evropian, në vitin 2016 u shpalla medalja e bronzë ndërsa një vit pas më 2017 në kampionatin mediterian në Antali të Turqisë arita të fitoi medaljen e artë. Pas gjithë këtyre suksesëve arrita të mbush normën për pjesëmarrjen në lojërat Olimpikë për të rrinjë, ku u zhvillua në Buenos Aires të Argjentinës, në këtë kompeticion arrita të bëj histori dhe u stolisa me medalje të bronzë. Kjo ishte medalja e parë Olimpikë për sportin e karates në historinë e RMV-së.

Fahik, ju cekët shumë suksese, mund të veçosh një prej tyre?

- Padyshim që medalja e bronzë në lojërat olimpikë ishte historike. Të gjithë e dimë se vetëm mbushja e normës apo vetëm pjesëmarrja në një kompeticion siç janë lojërat Olimpikë, është madhështore. Unë në momentin që mbusha normën për të marë pjesë në lojërat Olimpikë e realizova ëndrën time, andaj i thash vetës time duhet të zgjohem tani nga kjo ëndërr si dhe të bëj atë që di më së miri " të luftojë " ... Unë bëra atë që di, luftova, si dhe arita të bëj histori, ti sjelli Maqedonisë së Veriut medalje olimpikë bronzi për të rrinjë, në shtëpi.

Cila është " formula " e suksesëve për ju, si aritët deri tek ato?

- Unë mendoj që formula e vetme e suksesëve është puna dhe vetëm puna!



INTERVISTË

Pas gjithë këtyre suksesëve Fahik Veseli tashmë jeni edhe një emër i njohur në vendin tonë, a ka ndikuar kjo në jetën tuaj?

- Të gjitha rrespektet që i jipen një sportisti për atë duhet të jenë motive që ai të ecë vetëm përpara. Për mua personalisht ka ndikuar pozitivisht pasi që njerëzit më kanë filluar të më respektojnë më shumë për shkak se së pari jam sportist e pastaj ndoshta edhe për shkak suksesëve.

Fahik, ju në fillim cekët se jeni edhe student në " Universitetin Nënë Tereza " a është e lehtë të menaxhohet shkolla dhe sporti njëkohësisht?

- Normal nuk është e lehtë, por unë mundohem që edhe në mësimet mos të ngeli mbrapa, këtu shfrytëzoj rastin që ti falenderojë të gjithë profesorët dhe kolegët që gjithmonë më mirëkuptojnë për shkak të angazhimeve të mia profesionale.

Cilët janë planet e juaja për të ardhmen?

- Tani për momentin jam duke u përgaditur për kampionatin Ballkanik që do të mbahet më 7 dhjetor, ku shpresoj që të arrij të rruaj medaljen e artë. Pastaj më pret kampionati shtetërorë për senior, ku mendoj se do të arrij të plasohem dhe të shkoj në European.

Për fund çfarë ju sugjeron të rinjëve kampioni Fahik Veseli?



BOTIMET AKADEMIKE DHE FONDI I LIBRAVE SI PJESË E DIJES PËR STUDENTËT!

Emel Aliju

Kur ne vizituar bibliotekën, aty takuam biblioteksiten Suveida Sali, e cila merrej me rregjistrimin e librave në sistemin COBISS. Pasi na priti me buzëqeshje na informoi se përgjegjësi i Qendrës së Botimeve Akademike dhe e Bibliotekës, prof.dr. Mustafa Ibrahimimi ishte në promovimin e botimeve akademike për vitin 2019. Promovoheshin dy botimet e profesorëve me përvojë akademike në Fakultetin e Shkencave Sociale, edhe atë: libri i prof.dr.Rizvan Sulejmanit me titull *Globalizmi dhe identiteti shqiptar : si u ndamë në "Ne" dhe "Ata"?* dhe libri i prof.dr. Sunaj Raimit *Filozofia e muzikës në Greqinë antike* (Филозофијата на музиката во Античка Грција) në gjuhën maqedonase. Në këtë ngjarje do të promovohet edhe numri i dytë i revistës "Interkultura", si përmbledhje e kumtesave të profesorëve eminent, që morën pjesë në Seminarin II të Multikultrës dhe Komunikimit Interkulturore që u mbajt më 11 nëntor 2019.

Profesor Ibrahimimi, në fillim falënderoi pjesëmarrjen në Promovim dhe interesimin për Qendrën, duke theksuar se *"Dija është forca motorike e zhvillimit të një shoqërie. Për shoqërinë e informacionit, e cila mbështet fuqishëm zhvillimin e bazuar në dije, botimet akademike dhe ato të veprimtarisë kërkimore shkencore janë pjesë shumë e rëndësishme të infrastrukturës, pa të cilat nuk mund të mendohet zhvillimi i arsimit bashkëkohor, i kërkimeve shkencore, dhe as zhvillimi kulturor, teknologjik dhe ekonomik"*.

U informuam, gjithashtu se vitin e kaluar ishin botuar edhe disa libra, midis të cilave : "Bazat e komunikimit masiv" nga prof.dr. Lindita Aliu-Tahiri, "Inxhinierimi Softuerik Sistemor" nga prof. dr. Bekim Fetaji dhe "Sociolinguistika" nga prof.dr. Mustafa Ibrahimimi.

Jo vetëm kaq, kjo qendër, kishte organizuar edhe dy seminare për multikulturalizmin dhe komunikimin interkulturore edhe atë: Seminari i parë më 15-16 tetor 2018 dhe Seminari i dytë më 11 nëntor 2019. Si rezultat i kumtesave të lexuara në këta seminare, ishin botuar edhe 2 numra të revistës shkencore universitare "INTERKULTURA", numri 1/2018 dhe numri 2/2019. Në kuadër të UNT-së, kishte ndihmuar edhe në botimin e revistave ndërkombëtare shkencore "South East European Journal of Sustainable Development"

" me dy numra në vit, si dhe 'Book of abstracts' për vitin 2017 dhe 'Book of abstracts' për vitin 2018, ndërsa për vitin 2019 është në përpunim e sipër.

Profesor Ibrahimimi, na informoi edhe lidhur me funksionimin e bibliotekës, duke na informuar se: "Në vitin 2018, u inicijua dhe u relaizua anëtarësimi i Bibliotekës së UNT-së në rrjetin rajonal të bibliotekave COBBIS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), i cili është model reference i sistemit që përfaqëson platformën e sistemeve kombëtare bibliotekare të informacionit dhe i sistemeve bibliografike për vlerësimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore në disa shtete, si në: Slloveni, Serbi, Maqedoni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Bullgari, Kosovë dhe Shqipëri. Së shpejti, Qendra jonë do të ofrojë edhe aplikacionin E-CRIS (sistem informues për veprimtarinë kërkimore). Në këtë mënyrë, UNT-ja po krijon një evidencë sa më të plotë të kërkuesve shkencorë dhe të veprimtarisë shkencore, e cila është e domosdoshme për përcjelljen dhe vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor. Sistemet kombëtare CRIS janë të lidhura me sistemet kombëtare bibliotekare të informacionit COBISS. Në këtë mënyrë ato mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë në bibliografitë e kërkuesve shkencorë dhe institucioneve kërkimore, pavarësisht ku janë botuar punimet. Përfshirja e të gjithë kërkuesve shkencorë të UNT-së në sistemin E-CRIS.MK do të kontribuonte në promovimin dhe rritjen e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu në vitin 2019, Biblioteka e UNT-së u bë anëtare e plotfuqishme në Shoqatën e Bibliotekistëve të Maqedonisë së Veriut, duke marrë pjesë në Konferencën e 46 Shkencore Ndërkombëtare të Bibliotekistëve, mbajtur në Shtip.

Në fund drejtori Ibrahimimi, na falënderoi për vizitën duke theksuar se, se për shkak të mungesës së hapësirës, kushtet nuk janë aq të përshtatshme për një bibliotekë moderne dhe efikase për studentët, porse stafi po trajnohet për funksionim sa më të mirë, edhe në këso kushtesh. Ata ishin optimist, se në objektin e ri që do të ndërtohet, kushtet do të jenë më të mira dhe më bashkëkohore, me çka studentët do të kenë kushte shumë më të mira, për të fituar më tepër dije dhe suksese në më të mira në studime.



...
...
...
SENSATIONALISM
...
...
...
...
...
...

...
...
...
CONSUMER
...
...
...
...
...
...
CELEBRITY
...
...

...
...
...
SCANDAL!
...
...
...
...
...
...
SEX TAPES!
...
...
...

**UNË E “DUA”
AUTO-CENZURËN**

UNË E “DUA” AUTO-CENZURËN

Sevdie Ramadani

Tashmë fjala censurë nuk është një fjalë e huaj, të gjithë, në një formë apo tjetër kemi dëgjuar diçka mbi këtë termë dhe ndoshta e kemi përjetuar herë pas here në ndonjë moment të jetës. Cenzura definohet në kuptim të zakonshëm si ndalim, kufizim apo ndëshkim por edhe si shqyrtim apo kontrollim i përmbajtjeve para se të botohen. Kjo duket se është prezente në shtypin e shkruar dhe elektronik. Por ajo çfarë duket edhe më shqetësuese në gazetarinë post- moderne është auto-cenzura, ku gazetari nuk është vetëm i ndikuar nga faktorë të jashtëm apo të brendshëm që ta zhvillojë punën me profesionalizëm dhe në përputhje me etikën gazetareske por është edhe kufizues i vetes së tij, konform me punën që ka krijuar duke mos patur sfida dhe pritshmëri të rreziqeve.


Po i perfshiej që të dyja, pasi që është e nevojshme të diskutohen sepse janë të lidhura sikurse zinxhiri i djallit, njëra pas tjetrës, mëkat pas mëkati. Dhe për fat të keq Maqedonia hyn në këtë llum, ku liria është në përmasa të vogla dhe ndonjëher po ti hysh një analize të thellë të duket sikur liria është diçka utopike dhe e pamundur. Emërtimi gazetar të asocon në diçka humane, e ndjeshme, punë delikate dhe elitare ose të paktën kështu është në syrin e atyre që merren me këtë punë, edhe në syrin tim që po e studioj këtë degë, por të pyesësh masën, të çfardo lloj moshe apo gjinie se ç'është gazetari thonë disa shprehje, disa fraza të çuditshme që herë pas here të bëjnë të mos e ëndërrosh një profesion të tillë, gati-gati paralelizohet me figurën e një politikani, si mashtrues, vjedhës dhe kriminel. Ngjasimi nuk është rastësi, ai sigurisht ka rrjedhur gradual me kohën dhe në qoftë se gazetari ka punuar në të mirë në drejtim të tij, në analizë të gjerë del se është punuar edhe në dëmtimin e imazhit të profesionit.

Sigurisht përgjithsimet në një mendje të shëndoshë nuk duhet të egzistojnë, por duhet të kujtojmë edhe shprehjen klishe të popullit që nuk është shpikur kot “ një mollë e kalbur, prish edhe të tjerat”. Por ajo çfarë na intereson apo preokupon është se sa ambicioz është gazetari në punën e tij për të arritur deri tek e vërteta edhe nëse rrethanat janë të tilla që e vërteta konsiston si një mister i pazbuluar. Në shoqëri nuk ka probleme misterioze, por mediat çdo ditë e më shumë po bëjnë që të duken të tilla dhe që gazetarët t'i shohin po të atillë, si probleme të pazgjithshme dhe që është pjesa e tyre të merren me to. Thone që rastesia është mbret i botës por ajo nuk ka të bëjë me gazetarinë ku gjithçka është e planifikuar dhe se nuk guxon të ndodhë e kundërta. Në një shtet, ku demokracia është vetëm në ambalazh, nuk guxon të jesh ndryshe sepse heshtja shihet si arma më e mirë e mbijetesës dhe keshilla është përshtatu sepse ndryshe karriera jote shkon në ajër në një mili sekond. Ende tek ne nuk kemi hasur në lajme të shpeshta, ku gazetarët janë vrarë por dihet se në bot, ndodhë që shumë gazetar i'a kane falur dhe jetën punës së tyre.

Sipas raportimeve të “Reporterëve pa kufij”, në vitin 2017 janë vrarë 64 gazetarë, nëpër bot. Dhe kur them që gazetari duhet të merr rreziqe mbi vete, nuk them për gazetarinë klasike si persona që prioritet e kanë të jen vip e pastaj të shohin çfarë detyre kanë. Gjithmonë flasim për zhanrin më të vështirë, ajo që është në pedestal, investigimin.

Pasi që flas vetëm me njohuritë e mia të përgjithshme për auto-cenzurën dhe censurën, kam zgjedhur që të pyes individët adekuat të këtij lloj profesioni dhe me pervojë pune, ku me pyetjet e mia hera herës nga kurioziteti i tepërt se si funksionojn mediat tona në Maqedoni dhe hera herës nga preokupimi se çfare barriera do ketë një gazetar i ri , arrita të zbuloj dhe të konkludoj se individët e medaive që frymojnë dhe punojnë jashtë kafazeve, janë sikurse ato gjallesat tjera që janë specie në zhdukje dhe që ministria e mjedisit nëpërmjet mediave alarmon shoqërinë përmes sanksioneve, që të mos vriten. Për fat të keq, ne nuk kemi një ministri të tillë që të na informoj apo alarmoj se gazetarët e mirfilltë po zhduken dhe ata që janë “ata” mundohen që t'a ç'rrenjosin shpirtin e kundërshtimit për çdo fatkeqësi që po ndodhë dhe po na rrethon, e ne si shoqëri jemi vaksinuar sikurse qent që të mos kafshojmë, thënë ndryshe të mos kundërshtojmë.

Duket se në shtete të demokratizuara në një copë letër, është e pakuptimt të kërkosh llogari nga shteti, sepse bie sikurse një dele të kerkojë ndihmë tek një ujku që të mos e haj ujku tjetër. Është shumë e lehtë për ta dalluar realitetin tonë, vetëm një sy kritik dhe kupton se si funksionojn jo vetëm mediat por edhe bota në përgjithësi. Funksioni i mediave, e sidomos puna e individëve që punojnë pra gazetarët, shpesh është



hermetikisht e mbyllur sa që është e veshtirë për tu gjeneralizuar cenzura dhe auto-cenzura. Organizata britanike për të drejtat e njeriut "Artikulli 19", ka raportuar se Maqedonia së bashku me Turqin, Brazilin, Bangladeshin dhe Burundin ka rënie të madhe në lirin e të shprehurit. Por edhe në intervistat që kam marrë, nga disa gazetarë shqiptar në lidhje me cenzurën dhe auto-cenzurën, pyetja që parashtrova ,se cila frikë i ndalon gazetarët më shumë. Përgjigjeshin se nuk ishin të mbrojtur aq sa duhej, pagat i kishin të ulëta, presioni i politikës dhe mos prishjen e "imazhit" të medias (kërkes absolute e punedhënsve)... Keshtu ata nuk e kundërshtojn cenzurën dhe mësohen me të dhe në raste të tjera e bëjnë si shprehi të veten në mënyrë automatike auto-cenzurën. Thellë-thellë ndoshta janë frymëzuar në thënien e piktorit italian të stilit barok Salvador Rosa "midis heshtjes dhe të folurit, heshtja është më e mirë".

Asgjë nuk mund të përjashtohet, e lemë si një enigmë por duke i'a kujtuar se ato nuk janë piktor për tu shprehur me figura e piktura dhe arti të jet heshtja, por arti i të thënit të gjërave troç, të kenë idhull të vërteten dhe të luftuarit me frikën mbrenda vetes së tij. Nga i gjithë ky sistem i ynë, më kujtohet edhe monologu i famshëm të dramaturgut Shakespeare" të rrosh apo të mos rrosh-kjo është çështja", në rastin tonë "të jesh apo të mos jesh gazetarë në "demokraci", kjo është çështja".

IKJA E RINISË NGA VENDI!



Ikja e rinisë nga vendi!

Punoi: Gentuar Ismaili

Trendi i ikjes jashtë vendit, në kërkim të kushteve dhe jetës më të mirë, tani është më aktual se kurrë. Fatkeqësisht nëse dikur vendin e lëshonin punëtor krahu, të njetën rrugë po e ndjekin edhe të rinjtë, të cilët janë diplomuar në një fushë të caktuar. Çdo ditë e më shumë, bankat shkollore po zbrazen, numri i nxënësve dukshëm është zvogëluar, fakultetet gjithashtu, por e njejta gjë ndjehet edhe nëpër institucione. Të dëshpëruar nga mënyra e jetesës në këtë vend, të rinjtë, por edhe të rriturit, po zgjedhin përfundimisht, si destinacion për të vazhduar të jetojnë dhe veprojnë. Si duket përqindje më e madhe e qytetarëve në shtet, do të jenë qytetarët të shtyrë në moshë.

Në një farë mënyre i mbështes të gjithë ata që e marrin një vendim të këtillë, sepse gjatë gjithë kohës po bëhen vetëm premtime boshe, po vazhdon punësimi në baza partiake, po lulëzon korrupsioni, po vazhdon diskriminimi në baza nacionale dhe po vazhdojnë problematika të ngjajshme. Mirëpo, mendimi im personal është që ne pikërisht ne të rinjtë, duhet të jemi ndryshimi i kësaj praktike të shëmtuar. Duhet të jemi zëri i fuqishëm dhe ardhmëria e këtij vendi sepse jemi shpresa e vetme, për të ju dhënë gjërave kahje të ndryshme nga të deritanishmet.

Sigurisht që mendoj se duhet të ketë mbështetje dhe investim nga ana e Qeverisë, sepse një fjalë e vjetër thotë se "Nëse dëshiron të shohësh sa demokratik është një shtet, shiko sa investon tek të rinjtë". Andaj mendimi por edhe lutja ime ndaj të gjithë bashkëmoshatarëve dhe të gjithë atyre që dëshirojnë ta lënë këtë vend, është që mos lejoni trojet tona të zbrazen dhe të mos lejoni që vendet tona nëpër institucione të zëvendësohen nga dikush tjetër. Shkollimin, përvojat, praktikën që i kemi marrë deri tani, duhet të vazhdojmë ti implementojmë në vendin tonë.

KOMUNIKIMI, PAJISJET E ZGJUARA NË EPOKËN DIXHITALE!




Komunikimi, pajisjet e zgjuara në epokën dixhitale!

Punoj: Arta Demçe

Ndërlidhja mes njerëzve përmes teknologjisë tashmë është bërë një realitet i pashmangshëm. E ashtuquajtura gjeneratë Z nuk e njih fare jetën pa pajisje teknologjike. Leximi i lajmeve, shfletimi i revistave, komunikimi me njerëz, apo blerjet e përditshme, të gjitha këto aktivitete njerëzit sot i bëjnë me anë të pajisjeve të zgjuara. Gjendemi në fillim të një burimi të ri të heshtur, ku shumica e asaj që dëgjojmë për teknologjitë është pozitive, por të besosh se mund ta drejtosh shumësin apo njerëzit, do të thotë të ëndërrosh për kohën e artë apo për botën e përrallave. Unë nuk jam kundër teknologjive, por kundër faktit që teknologjia po e zëvendëson, gjithnjë e më shumë komunikimin. Që nga vitet e hershme dhe jeta në shpella, komunikimi ka qenë pjesë e rëndësishme e jetës. Mirëpo a është në rrezik komunikimi real ndërmjet njerëzve në ditët e sotme, apo është „vlarë“ tashmë nga interneti? Kjo çështje është objekt studimi në shumë universitete botërore.

Në shumë studime të bëra është konstatuar se përdorimi i pajisjeve të mençura nga të rinjtë ka lehtësuar komunikimin, qasjen në informacione, ka mundësuar zgjidhjen më të shpejtë të problemeve matematikore, kryerjen e detyrave në lëndë të ndryshme, por nga ana tjetër ka vështirësuar zhvillimin e aftësive kreative dhe ka shkaktuar çrregullime të ndryshme në sjelljen e individit. Deri sa ka mospajtime lidhur me atë, nëse pajisjet e mençura vetëm e kanë lehtësuar, apo edhe përmirësuar komunikimin, për një gjë studiuesit janë të një mendimi: efektet negative që shkakton përdorimi i tyre tashmë janë evidente në shume aspekte. Gjithçka sot po shëndrrohet në pajisje të mençura (smart products) drita të mençura, para të mençura, makina të mençura, çdo gjë që mund të shitet po prodhohet, dhe ato po vijnë si një sulm i ndjeshmërisë tek ne, për shkak që po dominon pushteti i parasë!



Të bëjmë një pyetje të thjeshtë: Celulari në xhepin tonë është thjesht një celular, apo jo? Sigurisht që jo, ajo është një nga ato pajisjet e mençura psikologjikisht e fuqishme që ndryshon jo vetëm atë që ne bëjmë, por kush jemi. Ndonëse të qenit online dhe „connected“ tërë kohën mund të shihet si aspekt pozitiv, sidomos në situata emergjente, mundësia për të pranuar mesazhe dhe për të qenë në komunikim të pandërprerë shkakton huti dhe shpërqendrim.


Shifrat e aksidenteve në rrugë, si pasojë e përdorimit të celularëve gjatë vozitjes, sipas policisë së shtetit kanë shënuar rritje viteve të fundit. Teknologjia shkakton sjellje hutuese tek njerëzit edhe në shtëpi, apo dhe shpërqendron vëmendjen gjatë kryerjes së punëve të rëndësishme. Disa familje debatet e tyre i kryejnë nëpërmjet email-it facebook-ut, duke shmangur ballafaqimin ballë për ballë, thënë ndryshe shumica e njerëzve zgjedhin të komunikojnë me të tjeret nëpërmjet rrjeteve, ku mund të modifikojnë veten. Është në rregull të mendohet se këto pajisje na e lehtësojnë menyrën e jetesës por gjithçka bëhet për shkak të ekonomisë jo se dikush do të na e lehtësojë menyrën e jetesës. Madje hulumtues të tjerë flasin edhe për ndikimin kryesisht negativ që përdorimi permanent i pajisjeve teknologjike ka në marrëdhëniet në çift, apo në komunikimin dhe performancën e njerëzve në punë. Një rrezik tjetër që na kanoset si pasojë e komunikimit

nëpërmjet teknologjisë është cënimi i privatësisë. Ky fenomen po shtohet dhe ne jo që jemi të rrezikuar se dikush mund ta përdorë privatësinë e rrjeteve sociale, por ajo mund të cënohet në shtëpinë tonë, dhomën tonë, duke i përdorur këto pajisje.

Më herët këtë vit, një çift nga Sinsinati (SHBA) u tmerruan kur dëgjuan një haker duke bërëit "Zgjuhu" në vajzën e tyre 10-muajshe, nëpërmjet një monitori Foscam që ata kishin vënë në dhomën të vajzës. Çdo pajisje ne jetën tonë lidhet me internetin gjithçka po zëvendësohet me "trurin robotik" gjithashtu ajo po ul nivelin e lëvizjes punëtore dhe ajo po bëhet realiteti i jetës tone. Duke qenë „të lidhur“ pas pajisjeve deri në 12 orë e më shumë në ditë, njerëzit kanë krijuar një rreth të gjerë shoqëror në rrjete sociale dhe po mjaftohen me jetën virtuale, mirëpo kanë një numër tejet të vogël të miqve të vërtete dhe jetojnë faktikisht në izolim social.

Disa nga pasojat, gjithnjë sipas studimeve janë depresioni, vetmia, pagjumësia, mungesa e privatësisë, varësia, humbja e dëgjimit dhe shikimit, apo edhe paaftësia për të kërkuar ndihmë nga të tjerët, në rast nevojë. Për atë arsye duhet të jemi më të ndërgjegjshëm me kohën që e shpenzojmë me teknologjitë. Ato gjithashtu kanë ndikime të thella në mënyrën se si fëmijët mendojnë dhe ndjehen. 63% e njerëzve preferojnë të përdorin kompjuterin ose teknologji të tjera, ku ajo ndikon në mënyrën se si fëmijët shoqërohen dhe bashkëveprojnë me të tjerët, të cilat mund të kenë ndikime të mëdha në mirëqenien e tyre mendore dhe emocionale. Tani është bërë e ditur se përdorimi i tyre në nivel të lartë, si fëmijët ashtu edhe të rriturit, mund të ulin vetëbesimin dhe të krijojnë humor negativ.

Ne nuk duhet të jemi të varur nga këto produkte, duhet ta dimë që çdo problem e ka një zgjidhje, zgjidhja e këtij problemi mendoj që është se neve duhet të mundohemi të funksionojmë sa më "normal" të kalojmë sa më shumë kohë me familjen, shoqëri të mendojmë sa më shumë për veten tonë, të modifikojmë sjelljen tonë, të merremi sa më shumë me art (terapia më e mirë mendore dhe shpirtërore) dhe e fundit ta kuptojmë realitetin! Nëse keni biseda më të gjata me Siri-n, se sa me njerëzit e vërtetë, ndoshta është koha e fundit për ta lënë anash celularin. Dhe në fund më lind pyetja: mund të jetë kjo një kurth për njerëzit apo i'u bëhet ves njerëzve dhe nuk e imagjinojnë jetën pa këto pajisje të zgjuara?! Nëse ka një mësim për të mësuar rreth parashikimit të epokës dixhitale është kjo: Më të mirët dhe më të zgjuarit shpesh e kanë gabim.



Shpërngulja e trurit!

Punoi: Emrah Xhemali

Që nga civilizimet e hershme, shpërngulja prej një vendi në një vend tjetër ka qenë gjithmonë prezente në botë, gjithmonë njerëzit nevojën për furnizim e kanë kërkuar në një vend tjetër. Një mënyrë për t'i tejkalar sfidat e kohës në të cilën jetojnë. Kjo shpërngulje ka vazhduar të jetë prezente edhe me fillimin e industrializimit dhe modernizimit. Shpërnguljet që ndodhën në vitet e modernizimit mund ti quajm "shpërngulje muskuloze", të cilat ishin shpërngulje ku numri më i madh përbëhej nga fuqia punëtore dhe kjo e bën që të dallojë nga "shpërngulja e trurit".



Sipas statistikave të Eurostat'it, nga viti 2010 deri në vitin 2019 nga Maqedonia e Veriut kanë ikur 230 mijë persona apo 10% e popullatës. Dany Bahar është një nga anëtarët mësimor në Universitetin Harvard i cili në një hulumtim shpjegon se me shpërnguljen e trurit nga një person, shteti është në humbje prej 30 mijë deri në 50 mijë dollar, në mvarësi prej punonjësve me cilësi të lartë kjo shumë arin deri në 150 mijë dollar. Me një shembull më konkret mund të themi se një familje harxhon prej 20 mijë deri 30 mijë euro për një person nga momenti që ka lindur e deri në moshën 25 vjeçare ose deri në diplomim. Shtetet e zhvilluara me pranimin e këtyre shpërnguljeve kursejnë nga buxheti i tyre këto harxhime dhe shtetet me më pak zhvillim në një farë mënyre thonë "kam ushqyer dhe rrit këtë person, kam shpenzuar materialisht dhe shpirtërisht për të, por nuk kam mundur që ta shfrytëzoj, urdhëro mere shfrytëzoje".

Pjesa më e edukuar, kualifikuar dhe e aftë e popullatës e cila vjen nga një vend më pak të zhvilluar ose në zhvillim dhe shpërngulet në një vend më të zhvilluar në kohën kur është më efikase mund të përcaktohet si shpërngulja e trurit. Me humbjen e trurit të vlefshëm, shteteve më pak të zhvilluara duke iu ngadalësuar zhvillimi, shteteve të zhvilluara edhe më tepër i shpejtohet.

Kur njeriu përpiqet për diçka gjatë jetës së tij, ai dëshiron të gjejë shpërblimin për mundin që e jep, nëse nuk do ta gjejë shpërblimin atëherë dëshiron të jetojë në një vend ku do ta gjejë atë shpërblim. Pagat e ulta në Maqedoninë e Veriut, normat e larta tatimore, jostabiliteti ekonomik dhe shqetësimi i të rinjëve për një ardhmëri të mirë është në të vërtetë shkaku më i madh i shpërnguljes së trurit. Kur qytetarët kompetent të një vendi shkojnë në vende të tjera për punë, nuk ka asnjë mënyrë që vendi të zhvillohet. Për shembull, ju keni një makinë, por askush nuk e di se si ta përdorë atë, në këtë rast makina nuk do t'ju bëjë dobi. Edhe për shpërnguljen e trurit vlen e njejta.

Nëse nuk ka ekspertë të mjaftueshëm për të përdorur mjetet në dispozicion, ai vend nuk mund të zhvillohet kurrë.

A white dove is shown in flight, with its wings fully extended. The bird is positioned on the left side of the frame, flying towards the right. The background is a solid, light blue color. The text "100 FJALË PËR PAQE!" is overlaid on the right side of the image in a bold, white, sans-serif font.

100 FJALË PËR PAQE!

100 fjalë për paqe!

Punoi: Hajrije Farizi

Jetojmë në një shtet ku qëllimi kryesor është antarsimi në Bashkimin Evropian si një garanci për paqe dhe liri, gjithë ky proces i vazhdueshëm reformues që vetëm të shihemi në sy të të tjerëve se ne jemi evropian dhe meritojmë të jemi pjesë e “familjes evropiane”, pse duhet ne të ndryshojmë për të na pranuar të tjerët, ndryshimet duhet të bëhen për neve “qytetarët” e jo për BE-në sepse paqja është vlerë e madhe, e drejtë njerëzore dhe meritë e çdonjërit dhe atë nuk na e garanton askush nëse ne nuk e ndërtojmë vetë dhe mendoj se të varesh nga të tjerët është dështim sepse edhe tek ne egziston potenciali dhe nuk mund të arsyetohemi se kemi mungesë të burimeve njerëzore po vetëm se mungon motivimi dhe se është zbehur dëshira e të qëndruarit në vendlindje dhe të kontribohet në atë pasi që është humbur kreatibiliteti institucional po gjithsesi mendoj se ka ardhur koha që të bindemi sidomos ne si rini se edhe këtu egziston mundësia, po mjafton t'i largojmë stereotipet negative dhe paragjykimet e të besojmë në ndryshime dhe të punojmë fort për atë, mos të lejojmë të na zotërojë injoranca po të krijojmë një shoqëri multikulturore, një shoqëri tolerante me mirëkuptim të ndersjelltë, duke krijuar diversitet kulturor në shtetin tonë mund të arrijmë shumë e më shumë por kjo nuk varet nga individët e caktuar por nga shoqëria si tërësi, në fillim ta bindim veten e më pas të tjerët se ne kemi kapacitete të mjaftueshme dhe për hirë të së ardhmës ti shpalojmë ato, të dalim nga kthetrat etnike dhe të punojmë për një të mirë të përgjithshme dhe të tregojmë se ne mund të ja dalim edhe vetë, edhe pa BE-në.

Mos të lejojmë të na shuhet edhe ajo pikë shprese që na ka mbetur neve si rini po le të ndërtojmë paqe, të lejojmë të lulëzon dashuria dhe harmonia në shoqërinë tonë, të ndërtojmë ura për besim, respekt dhe mirëkuptim me të gjithë sepse vetëm kështu mund ta shijojmë paqen e vërtetë dhe të jetojmë të lumtur në të.

Paqe për mua është të jem shqiptare, të jetojë e lirë dhe të ndjehem e plotësuar në Maqedoninë e Veriut. “Askush nuk mund të jua sjell paqen porpos ju vetë” - Ralph Waldo Emerson

Interneti, Programi Open-Source Software

Punoi: Rasim Ajredini

Me zhvillimin e internetit bota është bërë një fshat global. Jemi në një kohë ku në një mënyre a tjetër nuk ballafaqohemi me barriera si vendi, gjuha, kombësia ose rraca sepse mund të qasim njëri tjetrin ku, kur dhe si të duam. Përgjatë kohës që kalohet në internet, besoj që kemi hasur në fjalën "Open-Source" e cila në shqip përkthehet "Burim i hapur". Në këtë artikull do e thjeshtësojmë që të bëhet me e kuptueshme se çfarë është Open-Source.

Sipas Wikipedia, "Open-source software" është një program kompjuterik i cili kodi burimor është i licensuar nga autori që i ka të drejtat, por e publikon kodin burimor që njerëzit të mundin ta ndryshojnë, studiojnë dhe ta shpërndajnë tek njerëzit e tjerë për çfarëdo arsyeje. Koncepti i "Open-Source" fillimisht është filluar nga një iniciator pak më ndryshe se iniciatorët e zakonshëm.

Ai është Eric Raymond, haker i njohur ndërkombëtar. Në vitin 1999, Eric Raymond e publikoi një shkrim të titulluar "Katedralja dhe Bazari" e cila ishte një analizë reflektive nga komuniteti i hakerëve kundrejt principeve të softwareve falas. Pas këtij shkrimi të publikuar, browseri i njohur në atë kohë e cila quheshte "Netscape" u bë falas. Browsera të njohur si Firefox dhe Thunderbird, gurëthemet i kanë nga po i njejtë kod burimor. Programe open-source më të njohur globalisht janë : Ubuntu, Android, GitHub, Wordpress, Mozilla Firefox, Mozilla ThunderBird, Notepad++, FileZilla.

Projekte të shumta open-source qarkullojnë në internet në të cilat të gjithë mund të kontribojmë. Njerëzit që kontribojnë zakonisht nuk përfitojnë asgjë, përkundrazi vetëm individi apo kompania primare i shijojnë përfitimet e zhvillimit të programit. Por tani me ndryshimin e kohës, projekte të ndryshme mundohen ta ndryshojnë këtë rregull të pa shkruar duke zhvilluar një sistem shpërblyes në të cilin të gjithë që do kontribojnë për ndonjë projekt, të shpërblehen. Por është vetëm çështje kohe deri sa të arrijmë në atë pikë.

Me këtë, sa më shumë njerëz do të jenë të motivuar të fillojnë të punojnë me open-source dhe gjithashtu të motivojnë të tjerët të kontribojnë. Open-source po e ndryshon botën.

E cituar nga: @nairadaddy

<https://steemit.com/utopian-io/@nairadaddy/what-exactly-is-open-source-software-github-utopian>

Poetët e rinj, motivim për rininë!

Intervistë me autoren e poezive **Sejdina Azizi**

UNTstudenti: Të kemi ftuar për veprimtaritë tua por a mund të na flasësh pak edhe për cfar studion dhe me cka miresh?

Unë shkollën e mesme e kam kryer për mjeksi/farmacii kurse tash jam në studime në një drejtim krejtësisht ndryshe për media dhe komunikim ndërkulturore sepse ka qenë profesioni që e kam ëndëruar që e vogël dhe nga natyra jam tip që smë pëlqen të merem vetëm me një gjë por dua të kem njohuri në shumë drejtime.

UNTstudenti: Prej kur keni filluar të mereni me shkrime dhe kur i keni botuar për herë të parë?

Unë me shkrime kam filluar që në fëmijërinë e hershme saqë me kalimin e kohës si duket dashuria dhe përkushtimi për të rritet vazhdimisht. Kurse sa i takon botimit të parë ka qenë në klasë të shatatë ku i përmblodha disa prej poezive më të dashura dhe botova librin e parë me përkrahje financiare nga xhaxhai.

UNTstudenti: Po botimet tjera?

Pasiqë botova librin e parë sigurisht që nuk mendoja të ndalesha me atë por përkundrazi kisha edhe më shumë vullnet dhe ambicie për të vazhduar të shkruaj gjithmonë që inspirohesh. Pasiqë grumbullova përsëri disa poezi që mund të botoja edhe librin e dytë kuptova që fondacioni Albiz kishte hapur konkurs për botime dhe konkurova ku për fat të mirë në mesin e tre fituesve isha edhe unë ku e përkrahën veprën time financiarisht dhe i falenderoj përzemërsisht. Vazhdova me të njëjtën tempo shkruaja me gjithë shpirt dhe padyshim që puna mu shpërblye botova edhe librin e tretë ku më zgjaten dorën njerezit më të vecantë që kam njohur jo vetëm për faktin që tashmë janë familja ime por për faktin që kanë një besim dhe respekt pa kushte ndaj meje. Eshhtë i fejuari im, babai tij, dhe një prej kushërive të tij ku vetëm ua dorezova poezitë dhe ato janë marë personalisht me gjitha procedurat. Tash jam në pritje për botimin e librit tim të katërt por jo të fundit me të cilin kam konkuruar ne Ministrinë e Kulturës dhe pres që të dalin rezultatet.

UNTstudenti: Kush janë përkrahësit tuaj më të mëdhenj?

Përkrahësit më të mëdhej moral dhe financiar njëkohësisht si për ç'do njeri edhe për mua ka qenë dhe vazhdon të jetë familja ku tek to gjej forcën dhe dëshirën për të vazhduar gjërat që më përmbushin shpirtërisht. Mes të gjithëve është një person, apo ndryshe udhërefyesi im pa të cilin shkrimet e mia do mbeteshin vetëm në letër. Eshhtë shumë e pakët shprehja me fjalë për mirënjohjen dhe falënderimet që kam ndaj tij, bëhet fjalë për vjehrrin e tezës time të nderuarin Z. Baki Bakiu ku falë tij arrita ëndrën ta bëj realitet. Ai më ka përkrahur që para botimit të parë dhe vazhdon akoma me gjitha mundësitë që ka.

UNTstudenti: A ke menduar ndonjëherë që do botosh libra dhe si është ndjenja të mbash në dorë dicka që mban emrin tënd?

Thënë të drejtën nuk është se e kisha menduar ndonjëherë sepse më dukej dicka shumë e madhe dhe

në momentin që mar në dorë librat e mi ndjehem shumë e fortë dhe e sigurtë se mendoj që janë dicka që smund të mi mer askush.

UNTstudenti: A mendon që lexohen librat në vendin tonë, dhe a përkrahen shkrimtarët?

Me keqardhje të madhe do kisha thënë jo për të dy pyetjet. Leximi literaturës në përgjithsi ka rënë shumë e sidomos blerja e librave, gjithashtu edhe shkrimtarët dhe puna e tyre mendoj që nuk vlerësohen atë sa e meritojnë.

UNTstudenti: Dhe për fund një porosi të përgjithshme nga ana juaj?

Unë do ju kisha thënë të gjithëve sidomos moshatarëve të mi luftoni që ti realizoni ëndrrat tuaja por gjithmonë me këmbë në tokë dhe me mendje në kokë. Mos keni frikë nga vështirësitë sepse me mund dhe përkushtim do i arrini qëllimet që keni.

Intervistë me autorin e poezive **Jahja Abazi**

UNTstudenti: Dicka rreth vetes tuaj?

Unë Jahja Abazi i lindur në fshatin Sllupcan ku edhe kam kryer shkollimin fillor në "Faik Konica" kurse të mesmen në "Ismet Jashari" Likovë.

UNTstudenti: Kur filluat të mereni me letërsi?

Me letërsi kam filluar të merem shumë herët por shkrimet e mia arriten sukses gjatë viteve 2017/18.

UNTstudenti: A ka qenë dëshirë apo imponim që u kthye në dicka më të madhe?

Fillimisht ishte vetëm si dëshirë personale por me kalimin e kohës arrita deri tek botimi librit.

UNTstudenti: Si arrite deri te botimi librit?

Realisht kisha një grumbull poezish dhe mi kërkuan për revistën e shkollës së mesme pastaj më pyetën nëse do doja të botoja libër.

UNTstudenti: A ishte rrugëtim spontan apo e keni menduar?

Ishte rrugëtim spontan ku thujse ç'do ditë inspirohesh për të shkruar pa e menduar fare që do arrija deri këtu.

UNTstudenti: A ke pasur përkrahje?

Përkrahjen më të madhe e kam pasur nga shoqëria e klasës sepse tjerët as nuk e kanë ditur se merem me shkrime.

UNTstudenti: A do vazhdoni akoma të mereni me shkrime?

Padyshim që do vazhdoj sepse letërsia është dicka e bukur dhe do i kisha propozuar secilit të meret.

UNTstudenti: A ke plan për ndonjë vepër tjetër?

Në fakt poezi të shkruara kam por për ti botuar jo.

Prezantimi i fakulteteve nga studentët

UNTstudenti: A mund të na përshkruani Fakultetin tuaj?

Zenel Miftari student i Shkencave Sociale

Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin "Nënë Tereza", në Shkup studentëve të këtij fakulteti u jep mundësi që të fitojnë njohuri të reja në problemet shoqërore, në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një ashtu Fakulteti i Shkencave, u ofron studentëve të përfitojnë shkathtësi se si t'i zgjidhin këto probleme shoqërore kombëtare dhe ngatërresat në marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjithashtu Fakulteti i Shkencave Sociale, organizon konferenca të ndryshme në kuadër të studimeve në të cilën fton studjues të fushës sociale nga universitete të ndryshëm. Fakulteti i Shkencave Sociale, u jep mundësi të organizojnë ngjarje të ndryshme ku përmes këtyre ju mundëson studentëve që të përvetësojnë përvojat e tyre në të folur publik dhe "prekja" e evenimenteve më të rëndësishëm evropiane. Vlen të cekët se universiteti jonë, ka marrëveshje me Erasmus+ ku studentët tanë kanë mundësi që të ndjekin një cikël semestral në universitetet më prestigjioze në Evropë. Maturantët të cilët vendosin të ndjekin studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale, do të bëjnë një vendim të duhur në të cilën do të përfitojnë në fushën në të cilën vendosin të studiojnë dhe do të përgaditen në mënyrë profesionale për në tregun e punës.

Studente e Shkencave Teknike

Fakulteti i shkencave teknike bashkon disa fusha të inxhinierisë dhe teknologjisë informative për të gjetur kështu zgjidhje inovative dhe kreative në konstruktimin, dizajnimin, modifikimin, instalimin, mirëmbajtjen, testimin, operimin dhe prodhimin e prodhimeve të ndryshme.

Albana Jahi studente e Arkitekturës

Perkundrazi zgjedhjes se drejtimin te arsimit te mesem te cilen shumica nga ne e kemi bere nen ndikim te disa faktoreve te ndryshem,ku shumica kemi vendosur per ndonje drejtim per hire te shoqeris ose pjesa tjeter nen ndikimin e zgjedhjes se prinderve por ketu duhet cekur edhe nje nder faktorin me te rendesishem "mosha femijore" qe kemi pasur ate periudh e cila eshte nje nder fakte me i rendesishem qe ka ndikuar te gjdokush nga ne ,por ne nje menyre apo tjeter shum shpejte ariten ditet e fundit te perfundimit te arsimit te mesem dhe keto dite per ne u paraqiten si nje vendim me me shum pergjethesi nje vendim me shum i rendesishme por nje kohesisht dhe shqetsues per te gjith ne.

Vendimi per zgjedhjen e drejtimin te univerzitetit-duke filluar nga vetja ky vendim nuk mu paraqit aq i lehte sa e kam menduar, ne nje menyre nuk ishte nje vendim aq i lehte per tu vendosur sepse perpos deshires dhe nje qellimi te caktuar qe perpos meje te gjith kemi pasur qe nga femirija kishte dhe faktor tjere qe dueshte te miren parasyshe si per shembull vendosja e nje univerziteti te pershtatshem,nje univerzitet me kualitet te larte profesional dhe nje univerzitet qe do ta ofroje me te miren ne lidhje me drejtimin e zgjedhur.

Qe nga femirija nje nder endrat e mia ishte qe nje dit te behem nje arhitekte e sukseshme,ditet e fundit per vendosjen perfundimtare te zgjedhjes gjdo dit e me shum afroheshin dhe une gjdo dite e me shum isha e shqetesuar ne lidhje me vendimin tim .

Si zgjedhje perfundimtare per vazhdimin e arsimimit dhe realizimin e endres time zgjedha univerzitetin "Nene Tereza" ku edhe pse nje univerzitet i rri univerziteti "Nene Tereza" mua mu paraqit si nje zgjedhje e duhur nje univezitet i pershtatshem per mua dhe drejtimin tim te zgjedhur.

Para gjithqkaje ishte nje univezitet qe me ofrojti qe te vazhdoj studiimet ne gjuhen amtare, nje univerzitet me nje stafe te formuar profesional te profesoreve dhe kualitet te larte ne pjesen e praktikimit.

Si gjdo fillim edhe fillimi i univerzitet per mua u paraqit i komplikuar duke pasur parasyshe se aty hyra nga nje drejtim shum me ndryshe se drejtimi i mesem, perndryshe nga shumica e kolegeve qe kishin me shum informata dhe me shum dieni ne lidhje me mesimet fillestare une ne lidhje me drejtimin nuk kisha asnje informat sepse nga mjeksia ne arhitektur ishte nje hap shum i ndryshem ne shum aspekte, por me ndihmen e profesoreve dhe asistenteve ne menyre shum me te lehte arrita qe te nderlidhem dhe une ne punimet fillestare fal stafit te profesoreve profesional ne nje kohe shum te shkurte arita qe hapat fillestare ti mare ne menyren me profesionale te mundeshme.

Idaet Ethem studente e Teknologjisë ushqimore

Ç'do vendim që marim në jetë ka peshën dhe rëndësinë e vet. Përzgjedhja e fakultetit nuk ishte edhe aq e lehtë për mua sepse bëhej fjalë për të ardhmen time. Njëkohësisht doja një drejtim që do jetë fitimprurës dhe që kërkohet në treg. Pikërisht Nënë Tereza më ofroi studime në gjuhën shqipe edhe pse fillimisht kisha një lloj frike si pasojë e mendimeve dhe fjalëve të ndryshme që ndegjoja si psh: është universiteti i ri, nuk posedon kushte të mira praktike, ska objekt adekuat, por pavarësisht të gjithave erdha në përfundim që këto faktorë nuk luajnë aq rol të madh nëse në sëbashku me profesorët bashkëpunojmë dhe do arrijmë sukses prandaj nuk jam penduar aspak sepse tashmë jam viti dytë. Ushqimi paraqet një faktor të rëndësishëm jo vetëm në balancimin e peshës trupore por edhe në shëndetin e njeriut. Më pelqen të jem në dijeni për produktet dhe prodhimet e ndryshme ushqimore që ne konsumojmë sepse kohës fundit janë përhapur sëmundje të ndryshme që shpesh janë edhe vdekje prurëse për shkak të substancave të dëmshme që gjenden në ushqim. . Ne nuk studijojmë vetëm për përbërjen e ushqimit por edhe për proceset dhe

operacionet që ndërmiren për prodhimin e ushqimit. Vazhdimisht mësojmë mënyra për rritjen e jetgjatësisë dhe mbajtjen e cilësisë së produktit, mbrojtjen e ushqimit nga mikroorganizmat duke filluar nga lënda e parë deri tek produkti final i paketuar. Me pak fjalë më pëlqen teknologjia ushqimore dhe shpresoj që do të bëhem një inxhinierë e suksesshme e ushqimit.

Arda Asani studente e IT-se

R : A mund të prezentoheni ?

A : Përshëndetje. Unë quhem Arda Hasani. Jam 20 vjeçe dhe studioj Software Design. Jam studente e vitit të dytë.

R : A është programimi diçka që e keni bërë me qejf që nga fëmijëria,, apo jeni inkuadruar më vonë?

A : Prejse kam qenë fëmi më kane interesuar kompjuteret. Jam munduar që nga 5 vjet të instaloj lojera dhe programe te ndryshme në kompjuter. Kurioziteti më rritej çdo vjet e më shumë dhe unë jam munduar gjithmone të mësoj sa më shumë gjëra rreth pajisjeve të mençura. E kam bërë dhe vazhdoj ta bëj me gjithë dëshirë.

R : Si erdhi deri tek vendimi i bërë për studimet ?

A : Ashtu siç e përmenda, kurioziteti për kete drejtim më kishte lindur prejse isha shumë e vogël, keshtu qe e kisha shumë lehtë qe të sigurohesha rreth vendimit që e bëra. R : A është nga pasioni, apo diçka më pak/më shumë?

A : Është edhe nga pasioni edhe nga dashuria ime për teknologji. Mendoj se është njera ndër shpikjet me te bukura te njerezimit dhe çdo kush duhet ta dijë vlerën dhe rëndësinë e saj.

R : A merreni edhe me diçka tjetër pos me drejtimin e fakultetit ?

A : Po, jam edhe front-end designer dhe po mundohem te krijoj webfaqe me dizajne unike te mijat duke i perdore web gjuhet perkatese.

R : Çfare mendimi ke në pergjithësi për drejtimin tënd?

A : Mendoj që drejtimi im është njeri ndër drejtimet më të rëndësishme. Shume njerëz nuk e kane idenë se sa me vlerë dhe sa e vështirë është. Por megjithatë, jam shumë e lumtur dhe krenare me drejtimin që e zgjodha.

R : A mendoni të vazhdoni po me të njejtën edhe pas diplomimit ?

A : Po, patjetër. Kam planifikuar t'i vazhdoj edhe studimet Master të të njejtit drejtim dhe ta punoi në të ardhmën po të njejtën gjë si profesion. Shpresat që hobi të më bëhet profesion nuk mund të më zhdukën aq lehtë.

R : Ndonjë këshillë për në fund ?

A : Do te kisha dëshirë të jap këshillë për të gjithë ata që mendojnë të studiojnë këtë drejtim, veçanerisht vajzat. Ne qoftë se mendon se ky drejtim të pershtatet dhe të pëlqen, mos e mendo as dy herë dhe vetem vazhdo. Nuk e di as vet se sa persona me kane paralajmëruar qe ky është drejtim që i pershtatet vetëm meshkujve, por kjo nuk ndikoi tek unë aspak! Perkundrazi, tani me gjithë dëshirë jam duke e vërtetuar që në fakt unë dhe shumë kolege femra të mijat, jemi duke arritur sukses shumë me shumë sesa koleget e mi meshkuj!

Çfarë ofron UNT-ja?

UNT-ja na ofron dy kampuse në dy objekte të ndryshme të Shkupit, siç janë kampusi A dhe B në të cilën janë përfshirë pesë fakultetet e saja.

Në Kampusin A të UNT-së janë:

- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
- Fakulteti i Shkencave Teknike
- Fakulteti i Shkencave Teknologjike

Në kampusin B të UNT-së janë:

- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Informatikës


Si mund ta kontaktojmë UNT-në?

 www.unt.edu.mk

 [/untshkup](https://www.facebook.com/untshkup)

 [/unt.sk](https://www.instagram.com/unt.sk)

 [/unt.sk](https://www.snapchat.com/add/unt.sk)

 +389 2 3161 004

KALENDARI PËR VITIN AKADEMIK 2019 - 2020

Fillimi i vitit akademik 2019/20 dhe fillimi i procesit mësimor	01.10.2019
Kohëzgjatja e semestrit dimëror	01.10.2019 – 17.01.2020
Javët e kolokfiumeve në semestrin dimëror	
Java e parë	18.11.2019 - 23.11.2019
Java e dytë	13.01.2020 - 18.01.2020
Paraqitja e provimeve në afatin e rregullt	20.01.2020 – 23.01.2020
Mbajtja e provimeve në afatin e janarit/shkurtit	24.01.2020 – 13.02.2020
Vërtetimi i semestrit dimëror dhe regjistrimi i semestrit veror	13.02.2020 – 15.02.2020
Kohëzgjatja e semestrit veror	17.02.2020 – 30.05.2020
Javët e kolokfiumeve në semestrin veror	
Java e parë	30.03.2020 – 04.04.2020
Java e dytë	23.05.2020 – 30.05.2020
Regjistrimi i semestrit veror dhe paraqitja e provimeve në qershor 2019/20	01.06.2020 – 05.06.2020
Mbajtja e provimeve në afatin e qershorit 2019/20	08.06.2020 – 30.06.2020
Paraqitja e provimeve në afatin e shtatorit	24.08.2020 – 28.08.2020
Mbajtja e provimeve në afatin e shtatorit	31.08.2020 – 22.09.2020
Regjistrimi i semestrit dimëror 2020/21	23.09.2020 – 28.09.2020
Fillimi i vitit akademik 2020/21	01.10.2020

II. AKTIVITETE TË RËNDËSISHME TË UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” NË VITIN 2019/20

II. Datat e rëndësishme të cilat universiteti i shënon me aktivitete (ditë pune)

27 tetor - Themelimi i UNT-së
1 nëntor – Tribunë e UNT-së
24-25 nëntor - Konferencë e UNT-së
22 nëntor - Dita e alfabetit
28 nëntor - Dita e flamurit
7 mars - Dita e mësuesit
8 mars - Dita ndërkombëtare e gruas
9 maj - Dita e Evropës
maj – Konferencë e UNT-së
05 shtator - Dita ndërkombëtare e bamirësisë

II.1 DITË JO PUNE NË R.M.V PËR VITIN 2019

II.1.1 Për të gjithë qytetarët e R.M.V.
11 tetor, Dita e kryengritjes popullore
23 tetor, Dita e Luftës Revolucionare Maqedonase
8 dhjetor, “Shën Kliment Ohridski”
1 janar, Viti i Ri
7 janar, Krishtlindjet
20 prill, Pashkët, dita e dytë e Pashkëve
1 maj, Dita e Punës
24 maj, Fitër Bajrami, dita e parë e Fitër Bajramit
4 maj “Shën Kirili dhe Metodij” – Dita e edukatorëve gjithëslloven
2 gusht, Dita e Republikës
8 shtator, Dita e pavarësisë

II.1.2 Për qytetarët e fesë katolike
II.2.2 Për qytetarët e fesë ortodokse
1 nëntor, Festa e të gjithë shenjtoreve
25 dhjetor, Dita e parë e Krishtlindjeve
6 janar, festa e Buzmit, një ditë para Krishtlindjeve
19 janar Epifani (Uji i Bekuar)
17 Prill, E Premtja e madhe, e premtja para Pashkëve
5 qershor, Rrëshaja, e premtja para Rrëshajës
28 gusht, Dita e Shën Marisë

II.2.3 Për qytetarët e fesë muslimane
31 korrik, Kurban Bajrami, dita e parë e Kurban
Bajramit

II.2.4 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë nacionale
shqiptare

II.2.4 Për qytetarët e fesë katolike
22 nëntor, Dita e alfabetit shqip
13 Prill, Pashkët, dita e dytë e Pashkëve

II.2.5 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë serbe në
R.M.V.-ut
27 janar, Shën Sava

II.2.6 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë rome në
R.M.V.-ut
8 prill, Dita ndërkombëtare e Romëve

II.1.4 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë turke në
R.M.V.-ut

II.2.7 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë vllahe në
R.M.V.-ut
21 dhjetor, Dita e mësimit në gjuhën turke
23 maj, Dita kombëtare e vllahëve

II.1.5 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë boshnjake
në R.M.V.-ut
28 shtator, Dita ndërkombëtare e boshnjakëve

II.1.6 Për qytetarët-anëtarë të bashkësisë hebreje në
R.M.V.-ut
19 shtator, Jom Kipur, dita e parë e Jom Kipurit



UNT



unt.edu.mk